

**GJYKATA SUPREME**

**Prishtinë**

**Numri i lëndës:** PAII-KŽII-2/2016  
(P. 309/10 dhe P. 340/10 Gjykata Themelore e Prishtinës)  
(PAKR 52/14 Gjykata e Apelit)

**Data:** 20 shtator 2016

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro (kryetar dhe gjyqtar raportues), gjyqtari i EULEX-it Anders Cedhagen dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj anëtarë të kolegjit, të asistuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Sandra Gudaityte në cilësinë e procesmbajtësit, në lëndën penale kundër të pandehurit, në mes të tjerëve

S [REDACTED] H [REDACTED] [REDACTED]  
[REDACTED]  
[REDACTED]  
[REDACTED]

I dënuar për vepër penale **Krim i organizuar**, në kundërshtim me nenin 274(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tani e tutje KPPK), në lidhje me veprën penale **Trafikim me njerëz**, në kundërshtim me nenin 139, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, dhe në përputhje me nenet 6, 11, 15(1), 274(1), 39(1) dhe (2) dhe 57(1) dhe (2) i dënuar me 5 (pesë) vjet burgim, me gjobë prej 2500 (dymijë e pesëqind) euro që duhet të paguhet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë, dhe i është ndaluar ta

ushtrrojë profesionin e anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur ta ketë vuajtur dënimin me burim në plotësi.

*duke i shqyrtuar* ankesat kundër aktgjykimit PAKR 52/14 të Gjykatës së Apelit të datës 6 nëntor 2015 të paraqitura nga avokati mbrojtës R [REDACTED] G [REDACTED] në emër të të pandehurit S [REDACTED] H [REDACTED] më 7 mars 2016, dhe nga i pandehuri S [REDACTED] H [REDACTED] më 11 mars 2016;

*pas shqyrtimit të përgjigjes* lidhur me ankesën nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (tani e tutje "Prokuroria") të paraqitur më 5 prill 2016;

*pas mbajtjes së seancës publike* më 11 gusht 2016,

*pas këshillimit dhe votimit të mbajtur* më 20 shtator 2016;

*duke vepruar në përputhje* me nenet 411, 420 (1.4) dhe 422 në lidhje me nenin 430(2) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (tani e tutje "KPPP")

*merr këtë*

---

||

---

## AKTGJYKIM

---

**Pranohen pjesërisht** ankesat e paraqitura nga mbrojtësi R [REDACTED] G [REDACTED] për të pandehurin S [REDACTED] H [REDACTED] e datës 7 mars 2016, dhe nga i pandehuri S [REDACTED] H [REDACTED] më 11 mars 2016, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/14 të datës 6 nëntor 2015, sa i përket faktit se Gjykata e Apelit nuk ka vërtetuar dhe provuar të gjitha elementet e veprës penale të krimit të organizuar të kryer në lidhje me veprën penale të trafikimit me njerëz.

Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit ndryshohen si në vijim:

*Pika 1*

Vepra penale kundër S [REDACTED] H [REDACTED] e përshkruar në Pikën 1 është ri-cilësuar si mundësim nga pakujdesia i veprës penale të trafikimit, në kundërshtim me nenin 139(4) të KPPK dhe është refuzuar e kryer në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së (si në shkallë të parë), sepse S [REDACTED] H [REDACTED] në cilësinë e krye anesteziologut në Klinikën Medicus me dashje ka marrë pjesë në procedura mjekësore të paligjshme sipas ligjeve të Kosovës, përkatësisht në së paku 7 (shtatë) heqje organesh (veshka) për transplantime, të cilat kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore ndaj dhuruesve viktima duke ua dobësuar thellësisht organin vital, dhe nën këto rrethana dhe duke u bazuar në karakteristikat personale ai është dashur ta dijë se ishte duke u përfshirë në trafikim.

Kjo akuzë më pas është refuzuar në bazë të nenit 2(2) dhe (3) të KPPK-së, në lidhje me nenin 389(4) të KPPK-së, pasi tani vepra penale nga neni 171 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje “KPRK”) (në lidhje me nenet 3 (2) dhe (3), dhe 17(2) të KPRK-së) më nuk përfshin veprat e kryera nga neglizhenca.

*Pika 3*

S [REDACTED] H [REDACTED] lirohet nga vepra penale krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274(1) të KPPK-së, për shkak se në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së, nuk është provuar se ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar.

Prandaj aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ndryshohet në lidhje me përfundimin se S [REDACTED] H [REDACTED] ishte bashkëkryerës (“bashkë-komplotist”) dhe anëtar i grupit të organizuar kriminal pasi Gjykata e Apelit nuk i ka vërtetuar faktet e nevojshme për të treguar dashjen dhe faktet e tjera e domosdoshme për t’i plotësuar elementet përbërëse të veprës penale. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit i ka mbajtur të pandryshuara faktet e vërtetuara nga Gjykata Themelore, duke përfshirë edhe faktet lidhur me fajësinë.

*Pika 7*

Vepra penale kundër S [REDACTED] H [REDACTED] e përshkruar në Pikën 7 është ri-cilësuar në veprën penale lëndim i rëndë trupor i cili ka rezultuar me shkatërrim ose me dobësim të përhershëm thelbësor të organit apo pjesës së trupit të person, në kundërshtim me nenin 154(1.2) të KPPK-së, jo me nenin 154(2.4) të KPPK-së si në aktakuzë.

S [REDACTED] H [REDACTED] është fajtor për kryerjen e veprës penale lëndim i rëndë trupori cili ka rezultuar me shkatërrim ose me dobësim të përhershëm thelbësor të organit apo pjesës së trupit të person, në kundërshtim me nenin 154(1.2) të KPPK-së, për shkak se është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Së paku prej 15 majit 2008 deri më 31 tetor 2008, në Klinikën Medicus, S [REDACTED] H [REDACTED] në cilësinë e anesteziologut kryesor me dashje ka marrë pjesë në së paku 7 (shtatë) ndërhyrje kirurgjike për heqje të organeve (veshka) me qëllim të transplantimit, të cilat janë të kundërligjshme sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës. Heqja e kundërligjshme e veshkave ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor ndaj viktimave dhurues, përkatësisht duke rezultuar me shkatërrim ose me dobësim të përhershëm thelbësor të organit të tyre vital.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ndryshohet në lidhje me faktin se “ai po ashtu (...) së paku është dashur ta dijë se operimet për transplantim të veshkave ishin të kundërligjshme në Kosovë ” pasi kolegji pajtohet plotësisht me Gjykatën Themelore se “(...) Dr. S [REDACTED] H [REDACTED] duke qenë në cilësinë e anesteziologut (...) me vetëdije ka marrë pjesë në procedurat mjekësore të cilat kanë qenë kriminale dhe të kundërligjshme në bazë të ligjeve të Kosovës, përkatësisht heqjen e organeve (veshkave) për transplantim. Heqja e kundërligjshme e veshkave ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor ndaj viktimave dhurues, përkatësisht duke rezultuar me shkatërrim ose me dobësim të përhershëm thelbësor të organit të tyre vital”. I pandehuri ishte në dijeni për veprimet e tij, se këto veprime ishin të kundërligjshme dhe të dënueshme me ligj, dhe i ka kryer ato me dashje.

Është dëshmuar se S [REDACTED] H [REDACTED] ka marrë pjesë në ndërhyrjet kirurgjike të së paku 7 (shtatë) të personave të cilët kanë vuajtur lëndime të rënda trupore duke rezultuar me dobësim të përhershëm thelbësor të organit të tyre vital, me heqjen e njërës nga veshkat e tyre për transplantim:

- (1) Të dëshmitarit të mbrojtur W2 i kombësisë [REDACTED];
- (2) Të dëshmitarit të mbrojtur W1 i kombësisë [REDACTED];
- (3) Të dëshmitarit të mbrojtur W3 i kombësisë [REDACTED];
- (4) Të dëshmitarit të mbrojtur PM i kombësisë [REDACTED];
- (5) Të dëshmitarit të mbrojtur DS i kombësisë [REDACTED];
- (6) Të dëshmitarit të mbrojtur AK i kombësisë [REDACTED];
- (7) Të Y [REDACTED] A [REDACTED] i kombësisë [REDACTED];

Dënimi:

Në bazë të nenit 6, 11, 15(2), 154(1.2) të KPPK-së, S [REDACTED] H [REDACTED] dënohet me 3 (tre) vjet burgim për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor duke rezultuar me shkatërrim ose me dobësim të përhershëm thelbësor të organit ose pjesës së trupit të personit, në kundërshtim të nenit 154(1.2) të KPPK-së.


Në bazë të nenit 57(1) dhe 63(2) të KPK-së, S [REDACTED] H [REDACTED] i ndalohet ushtrimi i profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e vuajtjes së plotë të dënimit me burgim.

Pjesa e mbetur e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit e cila nuk është prekur me këtë aktgjykim mbetet e pandryshuar.

Pjesët e mbetura të ankesave refuzohen si të pabazuara.

## ARSYETIM

### I. Përbërja e kolegjit



1. Kolegji konstatoi se ky rast ishte caktuar te gjyqtarët e EULEX-it para datës 15 prill 2014 dhe për këtë arsye është konsideruar si një "rast në proces" në përputhje me nenin 1A (1.4) dhe 3 (1) të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (tani e tutje "Ligji nr. 05 / L-103") që *inter alia* ka ndryshuar Ligjin nr. 03 / L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tani e tutje "Ligji mbi kompetencat").
2. Kolegji në rastin në fjalë është përbërë para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05/ L-103, në përputhje me Ligjin 04 / L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, të miratuar më 23 prill 2014 dhe hyri në fuqi më 30 maj 2014 (tani e tutje "Ligji 04 / L-273") i cili në mes tjerash ndryshon Ligjin mbi Kompetencat dhe Marrëveshjen mbi aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët e Kosovës që punojnë në gjykatat vendore<sup>1</sup>, të nënshkruar në mes të shefit të EULEX-it Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 18 qershor 2014 (tani e tutje "Marrëveshja"). Në pajtim me nenin 1.a të Ligjit 04/L-273, dhe Pikën 2 të Marrëveshjes, kolegji ishte i përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarin e EULEX-it si kryetar të kolegjit.
3. Anëtarët e kolegjit u pajtuan se Gjykata Supreme e Kosovës ka juridiksionin kompetent dhe se procedurat e mëtutjeshme nuk janë të nevojshme.

## II. Historiku i procedurës

4. Më 15 tetor 2010, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (më tej "PSRK") ka ngritur aktakuzën PPS nr. 02/09 kundër S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe të pandehurve të tjerë. Më 21 tetor 2010, është ngritur Aktakuza PPS nr. 107/10, duke akuzuar individë të tjerë me disa vepra të ngjashme penale. Dy aktakuzat u bashkuan në një aktakuzë të vetme më 29 nëntor 2010. Bashkimi u konfirmua nga kolegji prej tre gjyqtarësh më 27 prill 2011. Aktakuza e vetme është ndryshuar më vonë dhe është zgjeruar më 22 mars 2013 dhe 17 prill 2013.

<sup>1</sup> Kjo referencë vetëm nga shumica e anëtarëve të kolegjit.

5. I pandehuri S [REDACTED] H [REDACTED] u akuzua për: Pika 1 - trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 23 KPPK; Pika 3 - krim të organizuar, në kundërshtim me nenin 274 (1) të KPPK-së; Pika 4 - ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore, në kundërshtim me nenin 221 (1) të KPPK-së; dhe Pika 7 - lëndim të rëndë trupor, në shkelje të nenit 154 (2.4), ose të nenit 154 (5), ose të nenit 154 (1.4) të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 23 të KPPK-së.
6. Gjykimi është mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe më 29 prill 2013 kjo gjykatë ka nxjerrë aktgjykimin P 309/10 dhe P 340/10. Vepra penale e trafikimit me njerëz (Pika 1) në shkelje të nenit 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje, ishte ri-cilësuar si mundësim nga pakujdesia i veprës penale Trafikim me Njerëz në shkelje të nenit 139, paragrafit 4 të KKPK-së dhe për rrjedhojë është refuzuar, në përputhje me nenin 2 (2) të KKPK-së pasi dispozita e re penale e trafikimit me njerëz nuk ka sanksionuar mundësimin nga pakujdesia<sup>2</sup>. Më tej, vepra penale e ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore (Pika 4) në kundërshtim me nenin 221 (1) të KKPK-së, të kryer në bashkëkryerje është refuzuar. S [REDACTED] H [REDACTED] i u lirua nga vepra penale e krimit të organizuar (Pika 3) në kundërshtim me nenin 274 (1) të KKPK-së. Gjykata Themelore më tutje ka ri-cilësuar Pikën 7 në lidhje me S [REDACTED] H [REDACTED] për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KKPK-së. S [REDACTED] H [REDACTED] u shpall fajtor për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KKPK-së, jo të nenit 154 (2.4) të KKPK-së sipas aktakuzës. S [REDACTED] H [REDACTED] më pas u dënua me 3 (tre) vjet burgim dhe i është ndaluar ushtrimi i profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.
7. Avokati mbrojtës i S [REDACTED] H [REDACTED] dhe mbrojtësit e të pandehurve të tjerë, si dhe PSRK-ja, kanë paraqitur ankesat e tyre kundër aktgjykimin P 309/10 dhe 340/10 P të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 29 Prill 2013, më 19 nëntor 2013, 26 nëntor 2013, 4 dhjetor 2013 dhe 10 dhjetor, 2013 - ky i fundit është paraqitur nga PSRK-ja në të cilën disa nga

<sup>2</sup> Sipas nenit 171 KPRK në lidhje me nenin 3(2) dhe (3), dhe 17(2) KPRK (që korrespondon me nenin 2(2) dhe (3), dhe 11(3) KPPK).

mbrojtësit e të pandehurve u përgjigjën më 9 dhe 10 janar 2014. Avokati mbrojtës i S [REDACTED] H [REDACTED] ka paraqitur ankesë më 26 nëntor 2013.

8. Më 6 nëntor 2015, Gjykata e Apelit lëshoi aktgjykimin e saj PAKR 52/14. Gjykata e Apelit pjesërisht pranoi ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të S [REDACTED] H [REDACTED] në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike, duke vendosur se numri i provuar i transplantimeve të veshkave që u zhvillua në Klinikën Medicus në të cilën ishte përfshirë organizata kriminale janë 7 (shtatë) në vend të 24 (njëzet e katër). Megjithatë, Gjykata e Apelit përfshiu të pandehurin S [REDACTED] H [REDACTED] në organizatën kriminale në fjalë. Prandaj, aktgjykimi i Gjykatës Themelore është ndryshuar lidhur me S [REDACTED] H [REDACTED] si vijon: S [REDACTED] H [REDACTED] i u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar në shkelje të nenit 274 (1) KPPK-së në lidhje me trafikimin me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 KPPK-së të kryer në bashkëkryerje<sup>3</sup>, në përputhje me nenin 23 KPPK-së (Pikat 1, 2 dhe 3). S [REDACTED] H [REDACTED] u dënua me 5 (pesë) vjet burgim, një gjobë prej 2 500 (dymijë e pesëqind) euro e cila duhet të paguhet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pasi aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë, dhe i është ndaluar ushtrimi i profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur dënimi me burgim të jetë vuajtur plotësisht.
9. Më 7 mars 2016, avokati mbrojtës R [REDACTED] G [REDACTED] në emër të pandehurit S [REDACTED] H [REDACTED] ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit PAKR 52/14 të Gjykatës së Apelit të datës 6 nëntor 2015, ku avokati mbrojtës ka kërkuar anulimin e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe që lënda të kthehet për rigjykim, ose të ndryshohen të dy aktgjykimet dhe S [REDACTED] H [REDACTED] të lirohet nga të gjitha akuzat.
10. Më 11 mars 2016, i pandehuri S [REDACTED] H [REDACTED] ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit PAKR 52/14 të Gjykatës së Apelit të datës 6 nëntor 2015, duke kërkuar nga Gjykata Supreme anulimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe që lënda të kthehet për rigjykim ose të lirohet nga të gjitha akuzat.

<sup>3</sup> Edhe pse Gjykata e Apelit përdor termin "bashkë kompletist" në dispozitivin e aktgjykimit të saj, ky është një gabim lehtë i justifikueshëm me anë të gjatësisë dhe kompleksitetit të këtij rasti. Është e qartë se Gjykata e Apelit e kishte fjalën për bashkë-kryerësit, pasi ne po flasim për një bashkë-kryerës duke qenë i pandehuri në këtë rast, gjë që shpjegohet nga Gjykata e Apelit në paragrafin e parafundit në faqen 62 të aktgjykimit të saj.



11. Më 5 prill 2016, Prokuroria dorëzoi përgjigjen e saj për ankesat e paraqitura nga i pandehuri L [REDACTED] D [REDACTED] i pandehuri S [REDACTED] H [REDACTED] dhe nga avokati mbrojtës në emër të S [REDACTED] H [REDACTED]. Prokuroria i propozon Gjykatës Supreme t'i refuzojë ankesat si të palejueshme në pajtim me nenet 422 dhe 430 (2) KPPK-së, ose në rast se Gjykata Supreme konsideron se ankesat janë të pranueshme, t'i refuzojë ankesat si të pabazuara në përputhje me nenet 423 dhe 430 (2) KPPK-së.
12. Më 11 shtator 2016, Gjykata Supreme mbajti seancën në përputhje me nenin 411 KPPP-së *ex vi* nenet 410 dhe 430(1.3) KPPP-së.

### III. Parashtrirat e palëve

#### - Parashtrirat e avokatit mbrojtës në emër të S [REDACTED] H [REDACTED]

13. Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 52/12 i datës 6 Nëntor 2015 përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Përveç kësaj, mbrojtësi kundërshton aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me vendimin për dënimin dhe për ndalimin e ushtrimit të profesionit të anesteziologut për periudhën prej 1 (një) viti. Për këtë arsye, mbrojtësi i propozon Gjykatës Supreme të anulojë aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe e çështjen ta dërgojë në rigjykim, ose të ndryshojë dy aktgjykimet dhe të lirohet S [REDACTED] H [REDACTED] nga të gjitha akuzat penale. Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës Supreme ta anulojë vendimin për ndalimin e ushtrimit të profesionit të anesteziologut për periudhën prej 1 (një) viti. Avokati mbrojtës pretendon se ankesa është paraqitur në pajtim me nenin 430 të KPPK-së.
14. Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara në nenin 384 (1.8), (1.12), dhe (2.2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej "KPP"). Ai pretendon se provat e administruara dhe të marra nga Gjykata Themelore në lidhje me të pandehurin S [REDACTED] H [REDACTED] janë të

papranueshme. Avokati mbrojtës pretendon se provat e vlerësuara nga Gjykata Themelore, përfshirë edhe provat e dhëna nga 7 (shtatë) viktimat dhe persona të tjerë të listuar në dispozitiv, nuk provon se S███ H███ kryer ndonjë vepër penale. S███ H███ vetë nuk ka hequr asnjë veshkë nga trupi i njeriut. Ai kishte një kontratë vetëm për shërbimet e anesteziologut. Prandaj, gjetjet në faqet 10 deri 12 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit se S███ H███ ka kryer ndërhyrje kirurgjike për të hequr veshkat janë në kundërshtim me natyrën e profesionit të anesteziologut.

15. Për më tepër, avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është hartuar në përputhje me nenin 370 (6), (7), dhe (8) të KPP-së. Aktgjykimi nuk përmban asnjë arsyetim të fakteve të konfirmuara, dhe nuk shpjegon se pse provat e paraqitura nga mbrojtësit dhe të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor nuk janë marrë parasysh. Aktgjykimi më tej nuk shpjegon rrethanat për dënim të rëndë. Vendimi i tillë shkel të drejtat e mbrojtjes, siç tregohet në nenin 384 (2.2) të KPP-së.

16. Avokati mbrojtës më tej pohon se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me veten e tij dhe me arsyetimin e aktgjykimit. Dispozitivi është në kundërshtim me provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

17. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të ligjit penal ashtu siç është treguar në nenin 385 të KPP, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, siç përcaktohet në nenin 386 të KPP. Aktgjykimi nuk ka marrë parasysh natyrën e profesionit të anesteziologut dhe gabimisht arrin në përfundim se S███ H███ ka kryer veprat penale të krimit të organizuar, trafikimit me njerëz dhe lëndim të rëndë trupore.

18. Në mënyrë të veçantë, avokati mbrojtës thekson se i pandehuri ka punuar vetëm si anesteziolog. Pozicioni i anesteziologut thjesht përfshin të paditurin si pjesëmarrës në ndërhyrje kirurgjike pasi ata paraprakisht janë caktuar për t'u kujdesur për mirëqenien e pacientit gjatë ndërhyrjeve kirurgjike. Për të mbështetur kërkesën e tij, avokati mbrojtës ofron një listë të detyrave të anesteziologut nga disa faqet të internetit. I pandehuri nuk ishte i përfshirë në planifikimin e ndërhyrjeve kirurgjike apo heqjen e veshkave. Përveç kësaj, i

pandehuri nuk ishte i përfshirë në përgatitjen dhe organizimin e transplantimeve. Për këtë qëllim, ai nuk ka marrë pjesë në gjetjen e dhuruesve apo të personave të cilët do të marrin veshkat. Në lidhje me dhuruesit e pretenduar, ai nuk ka organizuar ardhjen e tyre, pritjen, apo qëndrimin në Klinikë. Përveç kësaj, i pandehuri nuk ishte i përfshirë në çështjet që lidhen me pagesat dhe rekrutimin e personave për heqjen dhe transplantimin e veshkave. Për këtë arsye, gjykatat nuk kanë provuar elementet e veprave penale të krimit të organizuar dhe trafikimit me njerëz.

19. Mbrojtja më tutje pohon se veprimet e S [REDACTED] H [REDACTED] si anesteziolog janë konsideruar gabimisht si veprime që shkaktojnë lëndime të rënda trupore. I pandehuri nuk i ka takuar pacientët dhe nuk i ka pyetur nëse ata pranuan për t'i hequr veshkat e tyre. Gjykatat arritën në përfundimin e gabuar se i pandehuri vetë u ka hequr veshkat dhuruesve për transplantim. Kështu, gjykatat gabimisht konstatuan se S [REDACTED] H [REDACTED] është dashur ta dijë se ndërhyrjet kirurgjike ishin të kundërligjshme.
20. Për më tepër, avokati mbrojtës pretendon se Gjykata e Apelit gabimisht arriti në përfundim se i pandehuri ka shkelur dispozitat e Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për Shëndetësi Private. Përkundrazi, i pandehuri ishte duke punuar me kontratë si anesteziolog dhe për këtë arsye ai nuk kishte asnjë detyrim ligjor për t'u marrë me licencimin, regjistrimin ose aktivitetet e Klinikës.
21. Si pasojë e shkeljes së ligjit penal, dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dënimi me burgim dhe ndalimi i ushtrimit të profesionit të anesteziologut për një vit është i kundërligjshëm.

- **Parashtresat e S [REDACTED] H [REDACTED]**

22. I pandehuri pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 52/12 i datës 6 Nëntor 2015 përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për dënimin. Për këtë

arsye, i pandehuri i propozon Gjykatës Supreme të anulojë aktgjykimin Gjykatës së Apelit dhe çështjen ta dërgojë në rigjykim, ose i pandehuri të lirohet nga të gjitha akuzat.

23. I pandehuri pretendon se ai mori pjesë në ndërhyrjet kirurgjike në Klinikën Medicus vetëm në cilësinë e anesteziologut dhe është paguar bazuar në sasinë e punës që do ta kryente në Klinikë. Ai kurrë nuk ka marrë pjesë në trafikimin e njerëzve, nuk ka sjellë njerëzit në Kosovë të cilët kishin nevojë për ndërhyrjet kirurgjike, nuk ishte i përfshirë në organizimin e transportit ose akomodimin e tyre. I pandehuri nuk e dinte se Klinika nuk kishte licencë; ai ka supozuar se Klinika kishte licencë për shkak se ajo ishte e drejtuar nga një mjek profesor universitar i njohur ndërkombëtarisht.

24. Në fund, i pandehuri pretendon se Gjykata e Apelit nuk arriti të administrojë provat në seanca të hapura, dhe për këtë arsye shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale të krimit të organizuar dhe trafikimit me njerëz vetëm në bazë të 1 (një) seance, ndërsa Gjykata Themelore kishte mbajtur 106 (njëqind e gjashtë) seanca.

#### **- Parashtrësit e Prokurorisë**

25. Prokuroria në përgjigjen e tij i propozon Gjykatës Supreme t'i refuzojë ankesat si të palejuara në pajtim me nenet 422 dhe 430 (2) KPPPK, ose në rast se Gjykata Supreme konsideron se ankesat janë të pranueshme, t'i refuzojë ato si të pabazuara, në pajtim me nenet 423 dhe 430 (2) KPPPK.

26. Prokuroria parashtron se kur ndryshimi i gjendjes faktike i bërë nga Gjykata e Apelit do të kërkojë "vërtetim tjetër të gjendjes faktike", kjo do të lejonte paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit, në përputhje me nenin 430 (2) KPPP-së. Megjithatë, Prokuroria parashtron se ankesa e shkallës së tretë është e lejueshme vetëm kur Gjykata e Apelit e ndryshon gjendjen faktike në shqyrtim, në bazë të nenit 411 të KPPP-së. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit ka mbajtur vetëm seancë, në bazë të nenit 410 të KPPP-së.

27. Prokuroria më tej parashtron se Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në bazë të nenit 426 (1) KPPP-së, që do të thotë se Gjykata e Apelit ka konstatuar se faktet materiale ishin të vendosur siç duhet në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, por i dha një cilësim ndryshe për këto fakte. Në këtë drejtim, Prokuroria pretendon se nuk mund të konsiderohet se gjykata ka vërtetuar një gjendje tjetër të fakteve nëse vetëm ka plotësuar dhe formuluar më saktë përshkrimin e veprës penale.

28. Së fundi, Prokuroria pretendon se në rast se Gjykata Supreme konsideron se ankesa e të pandehurit është e pranueshme, atëherë vështrimet e Prokurorisë në mendimin e paraqitur nga Prokuroria e Apelit më 19 shkurt 2014 do të konsiderohen si pjesë përbërëse e kësaj përgjigjeje. Në përgjigjen e datës 19 shkurt 2014, Prokuroria e Apelit pretendonte se i pandehuri ishte në dijeni se ai ishte duke marrë pjesë, në cilësinë e tij si anesteziolog, në procedurat e paligjshme të heqjes së veshkave për transplantim, dhe si i tillë ka kontribuar ndjeshëm në dobësimin e përhershëm dhe të konsiderueshëm të një organi vital të dhuruesve. Elementet që vërtetojnë kontributin thelbësor të të pandehurit janë si në vijim: i pandehuri ishte anesteziologu kryesor pothuajse në të gjitha operacionet e transplantimit të veshkave që u zhvilluan në klinikën Medicus në kohën përkatëse; ai ka intervistuar të gjithë dhuruesit e mundshëm të huaj dhe pranuesit rreth reaksioneve alergjike dhe çështjeve të ngjashme e para ndërhyrjeve kirurgjike; si mjek ai duhet të ketë qenë në dijeni se transplantimet e veshkave janë të kundërligjshme në Kosovë dhe se Klinika Medicus nuk ishte e licencuar ose autorizuar për të kryer transplantime; dhe se pëlqimi eventual për heqjen e veshkave nga dhuruesit ishte i pavlefshëm pasi ishte një pëlqim për një procedurë të paligjshme mjekësore. Prokurori i Apelit më tej tregoi se Gjykata Themelore ka vlerësuar saktë rrethanat dhe shqiptoi dënimin plotësues ndalim të ushtrimit të profesionit të anesteziologut.

#### **IV. Ligji i aplikueshëm procedural**

29. Kolegji njëzëri vendosi që këto procedura rregullohen nga KPPP në përputhje me nenet 540 dhe 541, të dy si *a contrario*, dhe nenin 545 (1) të KPP-së. I njëjti përfundim do të rezultonte nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 43/2013, i datës 7 janar 2013.

## V. Pranueshmëria

30. Në përputhje me nenin 430 (1) të KPPK-së, ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet vetëm nëse përmbushen disa kushte. Neni 430 (1.3) i KPPK- së specifikon që mund të paraqitet ankesa në qoftë se gjykata e shkallës së dytë ka modifikuar aktgjykimin lirues nga gjykata e shkallës së parë dhe në vend të tij ka lëshuar një aktgjykim dënues. Në rastin konkret, Gjykata Themelore e liroi S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] nga vepra penale e krimit të organizuar (Pika 3) në kundërshtim me nenin 274 (1) të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 23 të KPPK-së. Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe shpalli S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] fajtor për kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar në shkelje të nenit 274 (1) të KPPK-së në lidhje me trafikimin me njerëz në shkelje të nenit 139 KPPK, të kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së. Prandaj, kolegji konstaton se ankesat e paraqitura nga avokati mbrojtës në emër të S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe nga vetë S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] lejohen pasi Gjykata e Apelit ka modifikuar aktgjykimin lirues dhe ka lëshuar aktgjykimin dënues. Në lidhje me këtë, kolegji thekson se kushtet për ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nga neni 430 (1.3) të KPPK-së nuk kërkojnë që gjykata e shkallës së dytë të mbajë seancë shqyrtimi e as të ndryshojë gjendjen faktike të lëndës. Thjesht modifikimi i aktvendimit nga aktgjykimin lirues në dënues është i mjaftueshëm për t'i konsideruar ankesat të pranueshme. Kjo është në përputhje me Komentarin e nenit 391 të Ligjit për Procedurë Penale të vitit 1982, i cili thotë se ankesat e shkallës së tretë janë të lejuara *“për shkak se vendimi ka qenë i miratuar në seancë të panelit, në procedurë që, në thelbin e saj, nuk është kontradiktore, dhe për shkak se vendimet krejtësisht të kundërta të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë ishin miratuar në dëm të të akuzuarit (vendimi lirues kundrejt vendimit dënues)”*. Ankesa e shkallës së tretë në këtë situatë është e nevojshme për të siguruar të drejtën e të pandehurit për një shqyrtim gjyqësor mishëruar në nenin 102 (5) të Kushtetutës së Kosovës.
31. Mjeti juridik i dhënë të pandehurit në aktgjykimin e kundërshtuar është i saktë. Kjo bazë për ankesë është e pavarur nga ajo e përcaktuar në nenin 430 (1.2) të KPPK-së të cilit i drejtohet Prokuroria. Pavarësisht nëse ka pasur ndonjë ndryshim në gjendjen e përcaktuar faktike, ajo

që ka rëndësi më shumë është se i pandehuri është dënua për vepra penale për të cilat ishte liruar, në mënyrë specifike, për krim të organizuar në lidhje me trafikimin me njerëz.

32. Megjithatë, çështja e ngritur nga Prokuroria meriton disa shpjegime. Në përputhje me nenin 420 (1.4) të KPPK-së, “*gjykata e shkallës së dytë mund në një seancë të kolegjit ose në bazë të shqyrtimit (...) të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë*”. Gjithashtu, neni 424 (1) të KPPK-së, *in fine*, sqaron se në lidhje me gjendjen faktike, vetëm nëse është e nevojshme, mund të përcaktohet një shqyrtim i ri gjyqësor para gjykatës së shkallës së parë - i cili nuk ka qenë vlerësimi i Gjykatës së Apelit . Neni 424 (4) të KPPK-së përsëri thekson se kur Gjykata e Apelit gjykon se ka vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe ku gjithçka që është e nevojshme për përcaktimin e saktë është vlerësim i ndryshëm i fakteve të përcaktuara më parë dhe nuk janë provave të reja të mbledhura ose përsëritje e provave të prodhuara më parë, atëherë Gjykata e Apelit mund të ndërmer veprim.
33. Logjika prapa kësaj shpie në përfundim se përderisa provat e paraqitura tashmë ia mundësojnë gjykatës që t'i ndryshojë faktet, ajo duhet të bëhet për aq sa thelbi i fakteve materiale vazhdon të qëndrojë – vetë Prokuroria pretendon në po të njëjtin kuptim. Vetëm në rast të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike është absolutisht e nevojshme që të pranohen prova të reja apo të përsëriten provat të cilat tashmë janë marrë (shih nenin 412 (1) të KPPK-së). Përndryshe, në qoftë se qëllimi i ligjvënësit ka qenë për të adresuar vetëm cilësimin juridik të fakteve, atëherë ligji do ta përcaktonte këtë në mënyrë të qartë. Ky përfundim është i justifikuar edhe nga zgjidhjet e ndryshme të përcaktuara në nenin 424 (3) të KPPK-së: aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë anulohet kur lindin dyshime serioze në lidhje me saktësinë e fakteve materiale të cilat janë përcaktuar në aktgjykim. Në fakt, do të ishte në dëm të të pandehurit që të ketë një rigjykim duke synuar në modifikim jo substancial të fakteve të vërtetuara, kur provat tashmë të paraqitura ia mundësojnë gjykatës shkallës së dytë që ta bëjë këtë.
34. Një tjetër pikë e cila vlen të adresohet në aspektin e interpretimit të ligjit, është situata kur aktgjykimi mbi refuzimin e akuzave është ndryshuar në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor – dispozita e këtij neni nuk e përmend këtë rast (në mënyrë eksplicite). Në

rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar një akuzë (të trafikimit me njerëz), e ka liruar të pandehurin nga një akuzë tjetër (krim i organizuar), dhe ka dënuar të pandehurin vetëm për lëndime të rënda trupore, ndërsa gjykata e shkallës së dytë e ka dënuar të pandehurin për krim të organizuar në lidhje me trafikimin e njerëzve. Prandaj, në shkallë të dytë, i pandehuri është dënuar, kur më parë ai ishte liruar nga njëra akuzë kurse akuza tjetër ishte refuzuar.

35. Si përfundim, mund të themi se norma e përcaktuar në nenet 430 (1.2) dhe 424 të KPPK-së **përbën të paktën një çështje të interpretimit**, kur referencë i është bërë një shqyrtimi, e jo një seance; Megjithatë, siç u tha, nuk ka asnjë ndryshim në dy situatat, **pasi që arsyetimi i normës së fundit është për t'ia mundësuar të pandehurit me një nivel të dytë të juridiksionit**, për t'ia siguruar të pandehuri një instrument për të kundërshtuar vendimin, ku gjendja faktike, disi, ishte ndryshuar. Një kuptim tjetër do ta privonte të pandehurin nga një nivel i dytë i juridiksionit vetëm për shkak të një aspekti formal: nëse ndryshimi është mbajtur në seancë ose në shqyrtim. Kjo do të çonte në shkelje të parimit kushtetues të përcaktuar me nenin 32 të Kushtetutës (E Drejta për Mjete Juridike). Në fund, në qoftë se çështja nuk është krejtësisht e qartë e mjaftueshme për t'i dhënë hapësirë këtij lloji të pyetjes, atëherë gjithashtu mund të thuhet se çështja duhet të përgjigjet me parimin e përcaktuar në nenin 3 (2) të KPPK-së, "(...) *mëdyshjet lidhur me zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit sipas këtij Kodi*".

36. Duke pasur parasysh këtë, ankesat janë të pranueshme.

## VI. Gjetjet e kolegjit

- **Shqyrtimi sipas detyrës zyrtare**



37. Kolegji do t'i adresojë argumentet e ngritura nga avokati mbrojtës dhe i pandehuri, edhe pse jo domosdoshmërisht me të njëjtin nivel të hollësisë në lidhje me të gjitha pohimet e bëra, pasi që në fakt kolegji nuk është i obliguar që ta adresojë secilin pohim<sup>4</sup>.
38. Kolegji, *ex vi* nenit 430 (2) të KPPK-së, duhet të vlerësojë çështjet kryesore të ngritura nga palët në lidhje me meritat e ankesës dhe, sipas detyrës zyrtare, shkeljet e listuara në nenin 415 (1) të KPPK-së. Është e qartë se shkeljet e listuara në nenin 415 (1.2) dhe (1.3) të KPPK-së, nuk kanë ndodhur, as ato të listuara në nenin 415 (1.1) të KPPK-së<sup>5</sup> - edhe pse vlen të përmendet se nën-paragrafi 1.2 është thelbësisht i lidhur me thelbin e ankesës dhe për këtë arsye do të kuptohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Së fundi, neni 415 (1.4) i KPPK-së nuk është shkelur, si dhe, kjo ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit në rastet e parapara në nenin 404 të KPPK-së<sup>6</sup>.

<sup>4</sup> Këtu po e citojmë nenin për të drejtën në gjykim të drejtë nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 6 i KEDNJ - [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf), f. 21.): "Arsyetimi i vendimeve gjyqësore" - Sipas jurisprudencës që reflekton parimin lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet në mënyrë adekuate të deklarojnë arsyet mbi të cilat ata janë bazuar (Papon v France.). Vendimet e arsyetuara i shërbejnë qëllimit për t'ia demonstruar palëve që ato janë dëgjuar, duke kontribuar për gatishmëri për t'ia pranuar vendimet nga ana e tyre. Përveç kësaj, ata i obligojnë gjyqtarët që vendimin e tyre ta bazojnë në argumente objektive, si dhe të ruajnë të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, shkalla e obligimit për të dhënë arsye ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (Ruiz Torija v. Spanjë, § 29). Ndërsa gjykatat nuk janë të obliguara për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument të ngritur (Van de Hurk v. Holanda, § 61), duhet të jetë e qartë nga vendimi se çështjet thelbësore të çështjes janë adresuar (shih Boldea v. Rumania § 30). Gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimin e tyre në mënyrë që t'ia mundësojnë palës ndërgjyqëse për të ushtruar të drejtën në ankesë (Hadjianastassiou v Greqinë.. dhe Boldea v Rumania)"

<sup>5</sup> Shkeljet substanciale të procedurës penale në vijim duhet të merren parasysh: neni 403 (1) nën-paragrafi I ("Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari ose gjyqtari laik i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi"), 2 ("Në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari ose gjyqtari laik i cili është dashur të përjashtohet"), 6 ("Aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes ose kur gjykata gabimisht ka refuzuar akuzën për shkak të moskompetencës lëndore"), 8 ("Aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme"), 9 ("akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për tërë akuzën ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave"), 10 ("Aktgjykimi ka tejkuluar akuzën"), 11 ("Me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 417 të këtij Kodi" - në lidhje me ndalimin *reformatio in pejus*, pasi që gjithashtu PSRK-ja është ankuar") dhe 12 ("Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërtshënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, kur aktgjykimi nuk përfshin arsyetimin ose në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, kur arsyet janë plotësisht të paqarta ose kundërtshënëse në masë të konsiderueshme, kur për faktet vendimtare ka kundërtshënje të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë dhe vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve").

<sup>6</sup> Neni 404 i KPPK-së përcakton si në vijim: "Shkelje e ligjit penal ekziston kur ligji penal është shkelur në çështjet: 1) Nëse vepra për të cilën i akuzuari ndiqet është vepër penale; 2) Nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale; 3) Nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale

- **Parimi thelbësor *Reformatio in Pejus* dhe fushëveprimi i këtij aktgjykimi**

39. Sipas nenit 417 të KPPK-së "*në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket vlerësimin juridik të veprës penale dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij*". Prandaj, ky do të jetë limiti i cili udhëheq këtë aktgjykim dhe kolegji do të përmbahet, deri në masën e mundshme, nga adresimi i cilësimit juridik të bërë nga të dy gjykatat, ku vepra të shumta penale të lëndimit të rëndë trupor [24 (njëzet e katër) në Gjykatën Themelore, dhe 7 (shtatë) në Gjykatën e Apelit] janë konsideruar vetëm si 1 (një) vepër penale. Vlera e mbrojtur juridike me veprën penale të lëndim i rëndë trupor është e natyrës personale (integriteti shëndetësore dhe trupor) dhe, për këtë arsye, numri i veprave penale duhet të korrespondojë me numrin e viktimave, por kjo do të trajtohet më vonë. Gjykata detyrohet me faktet apo "aktet" e përmbajtura në akuzë (parimi i identitetit subjektiv dhe objekti i aktgjykimit mbi aktakuzën). Në të njëjtën kohë, parimi i përcaktuar në nenin 386 (2) të KPPK-së, ose në nenin 360 (2) të KPRK-së tregon se "*gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës*". Do të ishte rast i bashkimit homogjen dhe real (pasi që nga pikëpamja natyrore aktet e të njëjtit lloj kanë ndodhur në momente të ndryshme në kohore, ose me kalimin e kohës) të veprave penale, sipas nenit 71 të KPPK-së ose nenit 80 të KPRK-së<sup>7</sup>, duke çuar në përcaktimin e një dënimi unik duke përmbledhur të gjitha veprat e ndryshme penale të kryera, edhe pse të të njëjtit lloj. Situata në rastin në fjalë nuk është një bashkim i dukshëm ose juridik, siç është trajtuar në të dy shkallët. Pasi që kjo do të shpinte në një dënim më të lartë, kolegji nuk mund të trajtojë këtë çështje në mënyrë efektive duke pasur parasysh parimin e përmendur më lartë

---

është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë a faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë; 4) Nëse lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet; 5) Nëse në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore; ose 6) Nëse janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të vuajtur".

<sup>7</sup> KPRK ka prezantuar një dispozitë të re që rregullon dënimin e veprave penale në vazhdim në nenin 81; Sidoqoftë, dhe pavarësisht në rastin në fjalë nën-paragrafët 1.1.4 dhe 1.1.5 të nenit në fjalë janë plotësuar, jo vetëm nën-paragrafi 1.1.1 nuk është plotësuar (pasi që janë 7 viktima), por edhe paragrafi 2 në mënyrë të qartë përcakton se dispozita e tillë nuk mund të zbatohet në një rast si ky.

- **(Pa)pranueshmëria e provave të marra gjatë bastisjes së hapësirave të Klinikës Medicus**

40. Gjykata Themelore ka gjetur se bastisja e kryer në hapësirat e klinikës Medicus e cila filloi më 4 nëntor 2008 dhe vazhdoi deri më 11 nëntor 2008 në fakt është kryer në shkelje të dispozitave të KPPK-së. Në mënyrë të veçantë, Gjykata Themelore ka përcaktuar se policia dhe prokurori publik kanë pasur kohë të mjaftueshme për të kontaktuar një gjyqtar për një urdhër me shkrim ose të paktën verbal, siç kërkohet me nenin 242 (1) të KPPK-së, dhe përjashtimet e parapara në nenet 242 (4), 245 (1.4), dhe 245 (3) të KPPK-së nuk ishin përmbushur në rastin në fjalë. Më tej, Gjykata Themelore ka arritur në përfundimin se bastisja është bërë në shkelje të nenit 243 (2) të KPPK-së, sepse nuk ka pasur persona të pranishëm si dëshmitarë, dhe përjashtimi i përcaktuar në nenin 254 (4) të KPPK-së nuk vlen për rastin në fjalë. Gjykata Themelore ka konstatuar se këto të meta normalisht do t'i bënin provat e marra gjatë bastisjes të papranueshme, në pajtim me nenin 246 të KPPK-së. Sidoqoftë, përfshirja e inspektorëve të shëndetësisë i bën provat e konfiskuara në klinikë të pranueshme për shkak se aktiviteti i tyre ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës 2004/4, Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi dhe Ligji për Inspektoratin Shëndetësor<sup>8</sup>.
41. Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me analizën e paraqitur në aktvendimin PPS nr. 02/2009 e Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 31 janar 2011<sup>9</sup>. Gjykata e Apelit u pajtua me Gjykatën Themelore se bastisje në hapësirat e Klinikës Medicus është kryer pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nuk ishin të pranishëm personat e nevojshëm. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk pajtohet se bashkëpunimi me inspektorët shëndetësorë e bën bastisjen të kundërligjshme. Edhe pse bastisja është bërë në bazë të dyshimit për aktivitete të kundërligjshme të kryera në Klinikë, prania e inspektorëve shëndetësorë nuk mund të përdoret për të legjitimuar bastisjen e kryer në shkelje të dispozitave të procedurës penale.

<sup>8</sup> Përfundimi i Gjykatës Themelore mund të gjendet në faqe 45 të aktgjykimit të Gjykatës Themelore P-309/10 dhe P-340/10.

<sup>9</sup> Shih faqet 45-49 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

Prandaj, Gjykata e Apelit ka shpallur provat e konfiskuara gjatë bastisjes si të papranueshme<sup>10</sup>.

42. Kolegji plotësisht pajtohet me analizën e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit në lidhje me shkeljet e nenit 242 (1) dhe (2) të KPPK-së. Provat e paraqitura në këtë rast, përkatësisht deklaratat e dëshmitarëve, në mënyrë të qartë tregojnë se bastisja në hapësirat e Klinikës Medicus është kryer pa ndonjë urdhër me shkrim ose me gojë të gjykatës, dhe nuk ka pasur dëshmitarë të pranishëm gjatë bastisjes. Këto të meta përbëjnë shkelje të nenit 246 (1) dhe (5) të KPPK-së dhe është bazë absolute për shpalljen e provave të mbledhura gjatë bastisjes të papranueshme.
43. Për më tepër, kolegji pajtohet me aktvendimin nr. 02/2009 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 31 janar 2011, se prania e inspektorëve shëndetësorë gjatë bastisjes penale nuk i bën shkeljet e KPPK-së të pranueshme, pasi që arsyet kryesore të veprimtarisë janë të ndryshme. Aktivitetet e inspektimit nuk zëvendësojnë përputhshmërinë ligjore të bastisjeve të kryera në hetime penale. Ndërsa bastisja e hapësirave private zakonisht ndërhyjnë në të drejtën e individit për jetë private, arsyet paraqitura për të justifikuar masat e tilla duhet të jenë relevante, të mjaftueshme dhe jo në disproporcion me qëllimin e ndjekur, duke qenë kjo arsyeja për kushtet ligjore për kryerjen e bastisjes në mënyrë të ligjshme.
44. Përkitazi me këtë, kolegji citon aktgjykimin e Gjykatës së Apelit: *“(...) ky është interpretimi i vetëm i mundshëm sipas nenit 36 paragraf 2 të kushtetutës së Kosovës sipas së cilës. “Kontrollet e çfarëdo vendbanimi privat ose pasi që të vërtetohet se është e nevojshme që të zhvillohen hetime kundër një krimi dhe zgjaten vetëm nëse shihet e nevojshme dhe vetëm pasi ta këtë miratuar gjykata dhe vetëm pas shpalosjes së arsytiveve se pse ky kontroll do t'i ishte i domosdoshme. Shmangja nga këto rregulla lejohet veten nëse shihet e nevojshme dhe nëse arrestimi është i ligjshëm, ka për qëllim grumbullimin e provave që janë në rrezik për tu humbur ose të behet shmangja direkte dhe nëse paraqitet rreziku serioz ndaj njerëzve dhe pasurisë siç parashihet me ligj.”<sup>11</sup> ‘Sidoqoftë, vlen të mbahet në mend kontrolli konkret nuk*

<sup>10</sup> Provat e papranueshme janë listuar në faqen 49 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>11</sup> *Shih*, paragrafin e parë të faqes 46 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

ishte i motivuar nga arsye shëndetësore siç parashihet me nenin 2 dhe 6 të ligjit në fjalë por "transplantimi i veshkës dyshohet se ka ndodhur pasi personi/shtetasi [REDAKTUAR] i cili ishte arrestuar nga policia e Kosovës kishte deklaruar se e kishte shitur një veshkë në atë spital", ndryshe nga ajo, siç përmendet ne raportin e Z. [REDAKTUAR] (...). Ishte e qartë se kishim të bënim me një kontroll kriminal, të motivuar pikërisht nga arsye kriminale (...)<sup>12</sup>". Gjykata duhet të jetë e kënaqur se kërkesat ligjore janë respektuar për t'ua mundësuar individëve një mbrojtje adekuate dhe efektive kundër çdo abuzimi të mundshëm. Në rastin konkret, bastisja u iniciua nga Policët me qëllim primar të hetimit të aktiviteteve kriminale në Klinikë. Policët i kanë përfshirë inspektorët shëndetësorë për të siguruar ekspertizën dhe mbështetjen e tyre gjatë bastisjes, duke pasur parasysh natyrën e objekteve si një klinikë mjekësore. Policët ishin përgjegjës për udhëheqjen e bastisjes dhe marrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme. Prandaj, kolegji konsideron se Gjykata Themelore gabimisht ka konstatuar se provat janë marrë nga inspektorët shëndetësorë në bashkëpunim me policinë. Bastisja është bërë si pjesë e aksionit hetimor kriminal të policisë e cila duhet të jetë në përputhje me dispozitat e KPPK-së. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar se autorizimi gjyqësor i bastisjeve është kusht thelbësor për kryerjen e bastisjeve<sup>13</sup>. Prania e përfaqësuesve të institucioneve të tjera të cilët i kanë rregullat e tyre të brendshme nuk mund të përdoret si një justifikim legjitim për të mos kërkuar autorizim gjyqësor për bastisje.

45. Rrjedhimisht, kolegji konstaton se Gjykata e Apelit ka përcaktuar drejtë se bastisja është kryer në shkelje të nenit 246 (1) dhe (5) të KPPK-së dhe nenit 36 të Kushtetutës së Kosovës. Prandaj, provat e sekuestruara gjatë kësaj bastisje të kundërligjshme do të konsiderohen si të papranueshme. Provat e mbledhura ose të analizuara në shkelje të kushteve të procedurës penale ose të të drejtave kushtetuese të të pandehurit janë të papranueshme për ndjekje penale pranë gjykatës. Gjykata e Apelit me të drejtë ka shpallur provat e konfiskuara gjatë bastisjes si të papranueshme<sup>14</sup>.

#### - Numri i transplantimeve të vërtetuara

<sup>12</sup> *Shih*, paragrafin e fundit në faqe 48 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>13</sup> *Shih*, për shembull, *Chappell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i 30 marsit 1989, dhe *Funke kundër Francës*, aktgjykimi i 25 shkurtit, 1993.

<sup>14</sup> Siç është cekur tashmë, provat e papranueshme janë listuar në faqe 49 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

46. Kolegji pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Apelit se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se janë kryer 7 (shtatë) transplantime të veshkave në klinikën Medicus. Provat në lidhje me këto shtatë transplantime janë bazuar në dëshmitë e 7 (shtatë) dëshmitarëve: W2, W1, W3, PM, DS, AK dhe Y [REDACTED] A [REDACTED] (ai ka dëshmuar në një seancë hetimore të jashtëzakonshme para gjyqtarit të procedurës paraprake) . Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë trajtuar në hollësi të madhe nga Gjykata Themelore (shih faqet 53-69 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës), dhe janë vërtetuar nga Gjykata e Apelit<sup>15</sup>. Kolegji plotësisht pajtohet me përfundimin e Gjykatës së Apelit në këtë drejtim.
47. Më tutje, kolegji pajtohet me Gjykatën e Apelit se nuk ka prova të mjaftueshme të pranueshme për të vërtetuar se 17 (shtatëmbëdhjetë) transplantimet e tjera janë kryer në klinikën Medicus. Provat e përdorura nga Gjykata Themelore për të mbështetur këto transplantime janë shpallur si të papranueshme nga Gjykata e Apelit<sup>16</sup>, dhe konfirmohen nga ky kolegji. Për më tepër, në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë tjetër të pranueshme për të vërtetuar këto 17 (shtatëmbëdhjetë) transplantime. Sidoqoftë, vlen të theksohet se vërtetimi i një fakti nuk korrespondon me deklaratën se faktet e pavërtetuara nuk kanë ndodhur. Gjykata e Apelit (përkatësisht në faqen 53 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12) nuk e përjashton se kanë ndodhur më shumë se 7 (shtatë) transplantime, por vetëm vërteton se provat e pranueshme i lejojnë gjykatës të konstatojë se kanë ndodhur 7 (shtatë) transplantime pasi që 17 (shtatëmbëdhjetë) të mbeturat nuk mund të vërtetohen në bazë të provave të pranueshme.
48. Prandaj, kolegji konsideron se vetëm 7 transplantime (shtatë) të veshkave janë vërtetuar se janë kryer në klinikën Medicus. Rrjedhimisht, nga pikëpamja logjike, në qoftë se vetëm 7 (shtatë) transplantime janë vërtetuar korniza kohore e fakteve të vërtetuara duhet të konsiderohet nga 15 maji 2008 deri më 31 tetor 2008 (sipas fakteve të vërtetuara nga ana e Gjykatës së Apelit në faqet 10 deri në 12). Kolegji vëren, në këtë drejtim, se ndryshimi i thjeshtë i datave nuk nënkupton asnjë pasojë juridike në lidhje me parashkrimin, elementet përbërëse të veprave penale, ose të bashkëpandehurve. Mos ndryshimi i datave në mënyrë të

<sup>15</sup> Shih faqen 52 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>16</sup> Shih faqet 45-49, faqe 52. dhe paragrafin e parë të faqes 53 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

përshtatshme me numrin e transplantimeve të vërtetuara mund të konsiderohet si një gabim *de minus* i bërë nga Gjykata e Apelit pa pasoja juridike.

- **Shkelja substanciale e procedurës penale**

49. Kolegji vëren se Gjykata Themelore ka gjetur S [REDACTED] H [REDACTED] fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së. Sidoqoftë, Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ka shpallur S [REDACTED] H [REDACTED] fajtor për veprën penale krimi i organizuar në kundërshtim të nenit 274 (3) të KPPK-së në lidhje me trafikimin me njerëz në kundërshtim të nenit 139 (1) të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së.
50. Në lidhje me këtë, kolegji konstaton se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i paqartë, sepse, as dispozitivi e as arsyetimi nuk tregojnë në mënyrë të qartë nëse S [REDACTED] H [REDACTED] është liruar për veprën penale lëndim i rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së.
51. Sipas nenit 396 (3) të KPPK-së, dispozitivi i aktgjyimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër të cilën ai ose ajo është i akuzuar ose me të cilin ai ose ajo është liruar nga akuza për atë vepër apo me të cilin është refuzuar akuza. Neni 396 (4) i KPPK-së përcakton se në rast se i pandehuri është liruar ose akuza është refuzuar, dispozitivi duhet të përmbajë një përshkrim të aktit për të cilin ai ose ajo është akuzuar. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit thjesht ka treguar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është modifikuar në bazë të nenit 426 (1) të KPPK-së pasi që i pandehuri është fajtor për veprën penale krimi i organizuar në lidhje me trafikimin me njerëz (siç është cekur në dispozitiv, në paragrafin e parafundit dhe të fundit të faqes 8 të aktgjyimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12) dhe të trafikimit me njerëz (siç është cekur në dispozitiv, në paragrafin e parafundit të faqes 9 dhe paragrafin e dytë të faqes 14 të aktgjyimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12). As arsyetimi, as dispozitivi i aktgjyimit nuk e përmend se S [REDACTED] H [REDACTED] është liruar nga vepra penale lëndim i rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së.

52. Sipas parimit të administrimit të duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të deklarojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat janë bazuar. Në rastin në fjalë, kolegji konsideron se mungesa e qartësisë në dispozitivin dhe arsyetimin e aktgjykimit krijon paqartësi, se për cilat krime i pandehuri është dënuar për cilat është liruar. Prandaj, kolegji konsideron se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç është përcaktuar me nenin 403 (1.12) të KPPK-së. Pavarësisht mungesës së çfarëdo reference në dispozitiv për një çështje të ngritur në ankesën e paraqitur nga prokuroria, mund të lexohet në arsyetim (në paragrafin e dytë të faqes 61 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12) se Gjykata e Apelit është pajtuar me vendimin e Gjykatës Themelore: *"i pandehuri nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën veprë penale"*. Gjykata e Apelit ka ndjekur të njëjtën logjikë si Gjykata Themelore në lidhje me të pandehurin L ■■■ D ■■■. Me fjalë të tjera, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se lëndimet e rënda trupore janë "pjesë" e veprës penale të trafikimit<sup>17</sup>. Pavarësisht se Prokuroria nuk ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh se kjo çështje ishte ngritur në pretendimet e prokurorit kur ka apeluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore, kjo çështje do të adresohet përsëri më vonë, pasi që me gjithë respektin për mendimin ndryshe, ky kolegji nuk pajtohet se vepra penale e lëndimit të rëndë trupor përbën element të trafikimit me njerëz, ose se do të ishte dënim i dyfishtë për të njëjtën veprë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh vendimin e kësaj shkalle, shkelja në fjalë deklarohet të ketë ndodhur, por nuk do të ketë asnjë pasojë juridike duke pasur parasysh këtë aktgjykim.

- **Akuza(t)<sup>18</sup> lidhur me veprën penale Trafikim me njerëz**

53. Në lidhje me S ■■■ H ■■■, Gjykata Themelore ka ri-cilësuar Pikën 1 të veprës penale të trafikimit me njerëz në shkelje të nenit 139 të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 23 të KPPK-së, në mundësimin e veprës penale të trafikimit me njerëz nga pakujdesia, në kundërshtim të nenit 139 (4) të KPPK-së, dhe ka refuzuar akuzën në pajtim me nenin 2 (2) dhe (3) të KPPK-së ose 3 (2) dhe (3) të KPRK-së (në lidhje me nenet

<sup>17</sup> *Shih*, për shembull, faqe 15 të aktgjykimit të Gjykatës Themelore P 309/10 dhe P 340/10 dhe faqe 61 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>18</sup> Pasi që ajo që lidhet me krimin e organizuar është domosdoshmërisht e lidhur me veprën penale të trafikimit me njerëz.



11 (3) të KPPK-së ose 17 (2) të KPRK-së, respektivisht), pasi që dispozita e re penale e trafikimit me njerëz, nenin 171 i KPRK-së, më nuk e ka paraparë mundësimin nga pakujdesia. Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pajtim me nenin 426 (1) të KPPK-së, dhe ka shpallur S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] fajtor për kryerjen e veprës penale krim i organizuar, në shkelje të nenit 274 (1) të KPPK-së në lidhje me trafikimin e njerëzve, në kundërshtim të nenit 139 të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 23 të KPPK-së.

54. Për të vlerësuar nëse gjetjet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit janë bërë në përputhje me gjendjen faktike dhe në përputhje me kërkesat e ligjit penal dhe të procedurës, kolegji do të fillojë me vlerësimin e akuzave penale lidhur me veprat penale bazë të trafikimit të personave dhe pastaj do të vazhdojë me vlerësimin e elementeve të veprave penale të krimit të organizuar dhe lëndimeve të rënda trupore.
55. Vepra penale e përshkruar në nenin 139 të KPPK, e titulluar "Trafikim me njerëz", ka për qëllim mbrojtjen e vlerave juridike të dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen nga shfrytëzimi, pavarësisht nga çfarëdo gjendje e ndjeshmërisë fillestare apo madje edhe pëlqimit. Vepra penale e trafikimit me njerëz mund të përfshijë, por nuk kërkon, lëvizjen: një individ mund të konsiderohet viktimë e trafikimit, pavarësisht nëse është zhvendosur nga njëri vend në tjetrin, i lindur në një gjendje të nënshtrimit, paraprkisht ka pranuar<sup>19</sup> që të punojë për një trafikant, ose ka marrë pjesë në një krim<sup>20</sup> si rezultat i drejtpërdrejtë i të qenit subjekt i trafikimit. Në thelbin e këtij fenomeni është qëllimi i trafikuesve për shfrytëzimin dhe skllavërimin e viktimave të tyre dhe praktikat e panumërta shtrënguese dhe mashtruese që ata përdorin për ta arritur këtë – siç ka ndodhur në rastin në fjalë, ku disa nga pagesat e premtuara nuk janë bërë. "Trafikimi me njerëz është skllavëria e kohës sonë. Viktimat shpeshherë rekrutohen, transportohen ose strehohen me forcë, shtrëngim ose mashtrimi në kushte shfrytëzuese, duke përfshirë shfrytëzimin seksual, punë të detyruar ose shërbime, kërkim i lëmshës, aktivitete kriminale, ose heqjen e organeve. Kjo është shkelje e rëndë e lirisë individuale dhe e dinjitetit

<sup>19</sup> Pasi që ligji dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare përcaktojnë se çdo pëlqim i viktimës është gjithmonë i pavlefshëm.

<sup>20</sup> Për shembull, të qenit prostitutë apo lypës në një shtet ku prostitucioni apo kërkimi i lëmshës është i kundërligjshëm.

dhe një formë e rëndë e krimit që shpesh ka implikime të cilat shtetet individuale nuk mund t'i adresojnë në mënyrë efektive"<sup>21</sup>.

56. Neni 139 i KPPK-së<sup>22</sup> përcakton tri elemente të nevojshme të veprës penale të trafikimit me njerëz: 1) rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pranimi i personave; 2) përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur qëllimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër; 3) me qëllim të shfrytëzimit. Shfrytëzimi është përkufizuar si "*shfrytëzimi i prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve*". Shprehja e përdorur nga ligjvënësi në nenin 139 (8.2) të KPPK-së ose 171(6.2) të KPRK-së, kur janë dhënë shembujt e shfrytëzimit, "por nuk janë kufizuar vetëm në ato" tregon se ekzistojnë edhe forma të tjera. Disa sisteme juridike nuk japin as shembuj të shfrytëzimit në raste të veprës penale të trafikimit, ia lënë gjykatës që thjeshtë të përcaktojë nëse ekziston; sistemet e tjera juridike kanë vepra të ndryshme penale (ose "nene") për situata të ndryshme varësisht nga forma e shfrytëzimit: për shembull, trafikimi për shfrytëzim seksual, trafikimi për heqje organesh, trafikimi për punë skllavëruese etj.

57. Këto tri elemente të veçanta formojnë *actus reus* dhe *mens rea* të veprës penale të trafikimit me njerëz. Dy pjesët e para konsiderohen si elemente objektive të veprës penale. Ndërsa pretendimi i cilitdo aspekt apo element të *actus reus*, duhet patjetër të vërtetohet se veprimi i pretenduar është bërë qoftë me qëllim specifik të shfrytëzimit të një personi tjetër ose me qëllim të veçantë për të lehtësuar shfrytëzimin e tyre nga të tjerët<sup>23</sup>. Elementi subjektiv (ose *mens rea*) "për qëllim të shfrytëzimit", përbën atë që quhet dashje e veçantë (jo vetëm dashja e drejtpërdrejtë, ajo duhet të jetë në mënyrë specifike e drejtuar për këtë qëllim), dhe kërkon

<sup>21</sup>Shih, [https://ec.europa.eu/antitafficking/sites/antitafficking/files/eu\\_strategy\\_towards\\_the\\_eradication\\_of\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2012-2016\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/antitafficking/sites/antitafficking/files/eu_strategy_towards_the_eradication_of_trafficking_in_human_beings_2012-2016_1.pdf)

<sup>22</sup> Përkritazi me këtë nuk ka asnjë ndryshim të rëndësishëm në nenin 171 të KPRK-së.

<sup>23</sup> Për dallim të kontrabandimit me migrantë, në veprën penale trafikim me njerëz pëlqimi i viktimës shpeshherë mungon (kurse tek kontrabandimi është gjithmonë i pranishëm) dhe shfrytëzimi zgjat aq sa është e nevojshme për të krijuar përfitimet për trafikuesin (kurse tek kontrabandimi përfundon sapo të arrihet destinacioni i paraparë i migrantit).

një gjendje subjektive të mendjes të drejtuar në pasojën e ndaluar - ose dashjen që të ketë pasojë të ndaluar, ose të ketë njohuri që ndodhja e saj ishte e sigurt. Prandaj, për ta përcaktuar elementin mendor të veprës penale të trafikimit me njerëz, është e nevojshme që të vërtetohet se personi ka pasur për qëllim të shfrytëzojë një person tjetër ose të lehtësojë shfrytëzimin nga të tjerët.

58. Avokati mbrojtës dhe i pandehuri kundërshtojnë aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, sepse kanë dështuar që t'i vërtetojnë elemente objektive të veprës penale të trafikimit me njerëz dhe kanë dështuar që të marrin parasysh se i akuzuari nuk ia ka hequr veshkat vetë, dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen dhe organizimin e transplantimeve. Në lëndën në fjalë, të dy gjykatat kanë gjetur se elementet objektive të veprës penale të trafikimit me njerëz janë vërtetuar<sup>24</sup>. Gjykatat kanë konstatuar se S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] ka vepruar si bashkëkryerës (edhe pse me cilësim të ndryshëm juridik në dy shkallët). Bashkëkryerja është formë e kryerjes, ku disa persona, secili prej tyre përmbush elementet e kërkuara të kryerësit, me vetëdije dhe vet dëshirë kryejnë akte të caktuara penale. Koncepti i përfshirë në nenin 23 të KPPK-së, ose nenin 31 të KPRK-së është shumë kompleks dhe i gjerë, subjekt i qasjeve të ndryshme doktrimore. Në formën më të qartë të bashkëkryerjes, duhet të ketë një marrëveshje të mëparshme dhe e vërtetë, ndërsa në format e tjera kjo "marrëveshje", mund vetëm të nënkuptohet, por në të dyja rastet, "pjesëmarrja" ose "thelbësisht duke i kontribuar" ende duhet të çojë në një kontribut të përbashkët objektiv të kryerjes së veprës së njëjtë penale. Në rastin konkret, S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] ka vepruar si bashkëkryerës në kufirin e njohurisë dhe qëllimit të tij [veprimet në lidhje me transplantimin e kundërligjshëm, lëndimet e rënda trupore, në përputhje me nenin 27 (1) të KPPK-së ose nenit 36 (1) të KPRK-së "bashkëkryerësi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së tij"]. Ai ka vepruar me ata të cilët kishin dashje të drejtpërdrejtë dhe specifike në lidhje me trafikimin me njerëz, por për të zgjeruar dashjen e tyre tek i pandehuri S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] do të kishte qenë e nevojshme të përcaktohen faktet e nevojshme për të përmbushur të gjitha elementet përbërëse të veprës penale, përkatësisht dashjen e tij specifike, e cila nuk është vërtetuar.

<sup>24</sup> Shih faqet 117 dhe 118 të aktgjykimimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe faqet 54 deri 56 të aktgjykimimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

59. Në lidhje me argumentin se nuk është vërtetuar se i pandehuri S ■■■ H ■■■ ishte përfshirë në organizimin e transportit, ose akomodimin e dhuruesve dhe klientit, apo se ai vetë i ka hequr veshkat, madje nuk duhet të jetë e nevojshme të thuhet se në bashkëkryerje është e nevojshme që të gjithë bashkëkryerësit e krimit të kenë kryer të njëjtat veprime materiale gjatë *intercriminis* (shumicën e kohës ajo është edhe materialisht e pamundur). Ekzistojnë prova që vërtetojnë se S ■■■ H ■■■ si anesteziolog ka kontribuar thelbësisht në transplantimin e kundërligjshëm të veshkave. Veprimet profesionale mjekësore si anesteziolog ishin kontribut thelbësor për verifikimin e elementeve objektive të veprës penale. Prandaj, kolegji refuzon pretendimin e avokatit mbrojtës dhe të S ■■■ H ■■■ se ky i fundit nuk ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të trafikimit me njerëz, si një pretendim i pabazuar.
60. Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, megjithatë, kanë arritur në përfundim të ndryshëm në lidhje me elementin mendor (*mens rea*) të veprës penale, në veçanti, në lidhje me fajësinë, neglizhencën apo dashjen. Gjykata Themelore ka konstatuar dhe Gjykata e Apelit ka konfirmuar se provat e paraqitura kanë mundësuar vërtetimin se S ■■■ H ■■■ ka marrë pjesë në një numër të operacioneve, ka ndërvepruar drejtpërdrejtë me të gjithë pacientët para operacionit dhe e ka ditur se ata ishin shtetas të huaj dhe se emri i tij është përmendur në një bisedë përmes e-mailit në mes J ■■■ S ■■■ dhe L ■■■ D ■■■. Përveç kësaj, ai ishte anesteziologu kryesor i cili ka angazhuar Dr. I ■■■ B ■■■ dhe Dr. S ■■■ D ■■■ dhe ishte përgjegjës për shpërndarjen e punës së tyre. Gjykata Themelore ka konstatuar se kjo provë nuk ishte e mjaftueshme për të vërtetuar dashjen direkte ose eventuale në lidhje me veprën penale të trafikimit me njerëz; sidoqoftë, është vërtetuar në mënyrë të qartë se në bazë të rrethanave dhe karakteristikave personale, S ■■■ H ■■■ duhet të ketë qenë në dijeni, dhe është dashur të jetë në dijeni, se ai ishte angazhuar në trafikim. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit ka konstatuar se kjo ishte e mjaftueshme për të konstatuar se veprimet e të pandehurit tregojnë të paktën dashjen eventuale për t'u angazhuar në trafikim me njerëz. Ky kolegji nuk mund të pajtohet me Gjykatën e Apelit në lidhje këtë.
61. Ekzistojnë dallime themelore midis formave të përgjegjësisë, përkatësisht dashjes dhe pakujdesisë. Ligji është i qartë në përcaktimin e këtyre koncepteve. Dashja është përcaktuar

si në vijim: “1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. 2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. 3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj”, kurse përkufizimet për llojet e ndryshme të pakujdesisë janë: “1. Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. 2. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj” (shih, përkatësisht, nenet 15 dhe 16 të KPPK-së, dhe nenet 21 dhe 23 të KPRK-së). Lidhur me përkufizimin e pakujdesisë së pavetëdijshme ekzistojnë dallime të vogla në formulim në të dy kodet: “Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi” (neni 16(3) KPPK-së) dhe “Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi” (neni 23(3) i KPRK-së).

62. Duke pasur parasysh këto nocione, dhe vendimet e përmendura (Gjykata Themelore duke vlerësuar pakujdesinë e pavetëdijshme dhe Gjykata e Apelit si dashje eventuale), mund të konstatojmë se: dashja eventuale siç është përcaktuar në nenin 15 (3) të KPPK-së vlen në situatat në të cilat i dyshuari është i vetëdijshëm për rrezikun që elementet objektive të krimit mund të rezultojnë nga veprimet apo mosveprimet e tij ose të saj, dhe (b) pranon një rezultat të tillë me pajtimin ose pëlqimin e tij apo të saj. Kjo përbën pranim të rrezikut nga një person, i cili megjithatë vazhdon dhe ndërmerr veprimin. Ndërsa pakujdesia e pavetëdijshme siç përcaktohet në nenin 16(3)<sup>25</sup> të KPPK-së ka të bëjë vetëm me situatën në të cilën personi i cili kryen veprën penale nuk është në dijeni për pasojat e mundshme të sjelljes së tij ose të saj

<sup>25</sup> Gjykata Themelore ka përdorë kodin e përkohshëm për pakujdesinë e pavetëdijshme; nenin 16(3) të KPPK-së – shih, fundin e paragrafit të dytë në faqe 12 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës themelore të Prishtinës.

në një situatë ku ai ose ajo duhet të ketë qenë në dijeni. Prandaj, dallimi kryesor në mes të dy standardeve është nëse personi ka qenë i vetëdijshëm për pasojat e mundshme të veprimeve.

63. Në rastin konkret, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë konstatuar se në bazë të rrethanave subjektive të njohura për S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] ai duhej të ishte i vetëdijshëm se operacionet në klinikën Medicus përfshinin transplantimin e veshkave. Ky përfundim mbështetet nga provat e paraqitura në këtë rast. Gjegjësisht, pozita e të pandehurit si anesteziolog kryesor, dhe se ishte i përfshirë në një numër të operacioneve [24 (njëzet e katër) në rastin e parë, 7 (shtatë) në rastin e dytë]. Përveç kësaj, sipas ekspertit mjekoligjor Dr. C [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR], kur një veshkë e shëndetshme merret nga një person i shëndoshë, qëllimi i vetëm i këtij operacioni është transplantimi i saj tek një person tjetër<sup>26</sup>. Prandaj, kolegji pajtohet me gjykatat e shkallës së dytë e parë se S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] e dinte se ishte duke marrë pjesë në transplantime të kundërligjshme të veshkave.
64. Sidoqoftë, kolegji nuk pajtohet me Gjykatën e Apelit se njohuria e transplantimit të veshkave e vërteton dashjen eventuale të të pandehurit për t'u përfshirë në veprën penale të trafikimit me njerëz. Elementi mendor i trafikimit me njerëz kërkon të vërtetohet se i pandehuri ka kryer njërin nga aktet përbërëse, duke përdorur njërin nga mjetet e listuara për këtë qëllim, ose, thënë ndryshe, me qëllim që individi të shfrytëzohet. Në mënyrë specifike, në rastin në fjalë, ka qenë e ishte e nevojshme të vërtetohet se i pandehuri ka qenë, nëse jo pjesë, të paktën në dijeni të sistemit të shfrytëzimit dhe, megjithatë; ka vazhduar me veprimet e tij si anesteziolog të cilat ishin thelbësore për operacione të suksesshme.
65. Kolegji është i mendimit se vetëm njohuria se operacionet kishin të bënin me transplantimin e veshkave, dhe duke e ditur se ishin të kundërligjshme, nuk vërteton se i pandehuri ishte në dijeni të shfrytëzimit, dhe si pasojë e trafikimit me njerëz<sup>27</sup>. Dashja në lidhje me një veprë penale nuk mund të ekstrapolohet në dashjen e një veprë tjetër - por kjo, natyrisht, do të thotë se Gjykata e Apelit ka pasur një kuptim të ndryshëm në lidhje me bashkimin e veprave penale lëndim i rëndë trupor dhe trafikim me njerëz. Gjykata e Apelit vlerëson se vepra

<sup>26</sup> Shih faqe 89 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

<sup>27</sup> Pasi që njëra çështje jo domosdoshmërisht vjen me tjetrën, transplantimi i kundërligjshëm mund të ndodhë edhe jashtë kontekstit të trafikimit me njerëz.

penale lëndim i rëndë trupor (heqja e një organi për transplantim) nuk është veprë penale autonome nga vepra penale e trafikimit me njerëz; në të kundërtën, ajo është pjesë e saj (kjo çështje do të trajtohet më vonë). Nuk ka asnjë provë për të vërtetuar se i pandehuri ishte në dijeni të rekrutimit, transportimit, transferimit, strehimit ose pranimin e dhuruesve të veshkave ose përfituesve, ose se ai kishte njohuri për pagesat e mundshme për dhuruesit dhe keqpërdorim të pozitës së tyre të ndjeshme. Edhe shkëmbimin e-mailave në mes të J [REDACTED] S [REDACTED] dhe L [REDACTED] D [REDACTED] tregon vetëm se S [REDACTED] H [REDACTED] kishte dhënë këshilla se cila pajisje është e nevojshme gjatë operacioneve për anestezion. Gjithashtu, fakti që i pandehuri e dinte se dhuruesit dhe klientët ishin shtetas të huaj, nuk vërteton se ai ishte në dijeni të trafikimit. Provat vërtetojnë vetëm njohurinë e të pandehurit (dhe dashjen) lidhur me transplantimet e kundërligjshme të veshkave, por jo njohurinë se ai ishte përfshirë në trafikim. Prandaj, *mens rea* lidhur me veprën penale të trafikimit me njerëz nuk është vërtetuar. Sidoqoftë, kolegji pajtohet me Gjykatën Themelore se duke pasur parasysh pozitën e të pandehurit dhe pjesëmarrjen e tij në transplantimin e veshkave, të cilën e dinte se është e kundërligjshme, të shpie në përfundim se ai ka kryer veprën penale të mundësimin të trafikimit me njerëz nga pakujdesia.

66. Edhe pse nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka pasur dashje, aq më pak dashjen (direkte) specifike të nevojshme për të kryer veprën penale të trafikimit me njerëz, provat në mënyrë të qartë vërtetojnë se në bazë të rrethanave dhe karakteristikave personale ai duhet të ketë qenë në dijeni, dhe duhet të ketë qenë në dijeni se ishte përfshirë në trafikim. Prandaj, kolegji pajtohet me përfundimin e Gjykatës Themelore se provat janë të mjaftueshme për të gjetur S [REDACTED] H [REDACTED] fajtor për mundësimin e trafikimit me njerëz nga pakujdesia. Por, para se të vazhdojmë, është e rëndësishme të theksohen se edhe dy çështje të tjera duhet të përmenden.
67. Së pari, duke pasur parasysh se Gjykata e Apelit ka ndryshuar faktet e vërtetuara lidhur me numrin e transplantimeve, Gjykata e njëjtë gjithashtu ka mundur të ndryshojë edhe fakte të tjera, përkatësisht, të vërtetojë fakte të reja lidhur me fajësinë e të pandehurit S [REDACTED] H [REDACTED] për sa i përket dashjes nëse ka pasur prova. Përkundrazi, Gjykata e Apelit nuk ka e ndryshuar këtë. Siç u theksua tashmë në fillim të këtij aktgjykimi (në dispozitiv), Gjykata e Apelit nuk

ka vërtetuar ndonjë fakt të ri lidhur me dashjen. Në lidhje me "nivele të fajësisë (...) përkritazi me dënimin e të pandehurit për krim të organizuar në lidhje me trafikimin e njerëzve", Gjykata e Apelit ka theksuar se "S. H., si anesteziolog kryesor në Klinikën Medicus, ka bashkëvepruar me shumicën nëse jo me të gjithë dhuruesit dhe pranuesit të cilët kanë qenë të përfshirë në të 7 operacionet për transplantimin e veshkave, gjatë përgatitjes së tyre për ndërhyrje kirurgjike, prandaj e ka ditur se të gjithë ata kanë qenë shtetas të huaj. Ky fakt është dashur, të paktën, të ngjallte dyshimin e tij se Klinika ishte përfshirë në trafikim"<sup>28</sup> (me theks të shtuar). Ky pohim i Gjykatës së Apelit korrespondon me një citat të pjesshëm të vendimit të Gjykatës Themelore<sup>29</sup> - ku faktet e përshkruara janë konsideruar si mundësim i trafikimit nga pakujdesia. Kjo nuk mund të konsiderohet si përshkrim i elementit *mens rea* si dashje eventuale ("Ky fakt është dashur, të paktën, të ngjallte dyshimin e tij se Klinika ishte përfshirë në trafikim"), kur në mënyrë të qartë është përkufizimi i pakujdesisë së pavetëdijshme. Gjykata e Apelit ka marrë në konsideratë këtë si dashje eventuale<sup>30</sup>, edhe pse korrespondon me pakujdesin e pavetëdijshme, siç është vërtetuar nga Gjykata Themelore.

68. Cështja e dytë është si vijon: edhe nëse Gjykata e Apelit ka vërtetuar një fakt në mënyrë të drejtë (dhe, natyrisht, e ka arsyetuar atë) që korrespondon me dashjen eventuale, veprat penale të cilat përbëhen nga dashja specifike (për shembull, në veprat penale kontrabandim me migrantë që kanë për qëllim përfitimin material, në veprën penale të trafikimit me njerëz me qëllim të shfrytëzimit, vepra penale e krimit të organizuar me qëllim të marrjes së drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një përfitimi financiar ose material, etj) mund të kryhet vetëm me dashje direkte. Dashja eventuale nuk është në përputhje me dashjen specifike (në qoftë se është përcaktuar me dispozitat inkriminuese, mundësimi nga pakujdesia mund të jetë gjithashtu një mënyrë e kryerjes).

69. Ekziston një supozim në ligjin penal që veprat penale kryhen me dashje; prandaj, në qoftë se një person është përgjegjës për kryerjen e veprës penale nga pakujdesia, kjo patjetër duhet të

<sup>28</sup> Shih paragrafin e parafundit në faqe 9 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>29</sup> Shih paragrafin e dytë në faqe 12 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

<sup>30</sup> Që mund ti atribuohet një gabimi për shkak të kohëzgjatjes dhe ndërlikueshmërisë së lëndës, pasi që dashja është vërtetuar në mënyrë të duhur në lidhje me të pandehurit e tjerë, për shembull në faqe 9 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut PAKR 52/12, në fund të paragrafit të tretë lidhur me A. D. "të gjitha këto aktivitete janë kryer me qëllim të (...)".



përcaktohet në legjislacion. Nenet 11 (3) KPPK-së dhe 17 (2) të KPRK-së përcaktojnë se "Një person konsiderohet penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e parashikon ligji". Në rast të trafikimit me njerëz, Gjykata Themelore me të drejtë ka arritur në përfundimin se kryerja e trafikimit me njerëz nga pakujdesia ka qenë në kohën kur veprimet kanë qenë të kriminalizuara me nenin 139 (4) KPPK-së si "mundësimi i trafikimit nga pakujdesia", e që nuk është paraparë me nenin 171 KPRK-së, në fuqi që nga 1 janari 2013. Pasi që provat e paraqitura në këtë rast janë të mjaftueshme për të vërtetuar dashjen e drejtpërdrejtë (apo edhe eventuale - në kuptimin e Gjykatës së Apelit) të të pandehurit për t'u përfshirë në trafikim, Gjykata Themelore në mënyrë korrekte ka ri-cilësuar pikën 1 në lidhje me S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] nga vepra penale trafikim me njerëz në kundërshtim të nenit 139 (1) KPPK-së, në mundësim të trafikimit me njerëz nga pakujdesia në shkelje të nenit 139 (4) KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje.

70. Kolegji, më tej pajtohet me Gjykatën Themelore se në rast të një ndryshimi të ligjit të zbatueshëm për këtë çështje të caktuar para vendimit përfundimtar, zbatohet ligji më i favorshëm për kryesin [neni 2 (2) dhe (3) të KPPK-së ose tani neni 3 (2) dhe (3) të KPRK-së]. Prandaj, në pajtim me nenin 3 (3) KPRK-së në lidhje me nenin 17 (2) të KPRK-së, kryerja nga pakujdesia është de-kriminalizuar me nenin 171 të KPRK-së. Prandaj, kolegji gjen se Gjykata Themelore ka zbatuar drejtë këtë parim dhe ka refuzuar pikën 1 në lidhje me S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR], sepse neni 171 i KPRK nuk e penalizon mundësimin e trafikimit me njerëz nga pakujdesia.

**- Akuza në lidhje me veprën penale të krimit të organizuar në lidhje me trafikimin me njerëz**

71. Në lidhje me veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274 (1) të KPPK-së (Pika 3), Gjykata Themelore ka liruar S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] për këtë akuzë, sepse nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm as njohuritë e tij, e as pjesëmarrjen në grupin e organizuar dhe të strukturuar, as ndonjë përfitim të mundshëm financiar. Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se, për shkak të rolit të tij si anesteziolog kryesor dhe përfshirjes së tij në transplantime të veshkave, S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] ka

pasur rol të rëndësishëm dhe vendimtar në grupin e organizuar kriminal, dhe për këtë arsye e ka shpallur fajtor për veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim të nenit 274 (1) të KPPK-së. Sidoqoftë, ky kolegji thekson se në lidhje me dënimin e të pandehurit për krim të organizuar lidhur trafikimin e njerëzve, dhe në lidhje me nivelin e fajësisë (paku jdesi, jo dashje), Gjykata e Apelit, nuk ka ndryshuar faktet e vërtetuara nga shkalla e parë: " S ■■■■■ H ■■■■■, si anesteziolog kryesor në Klinikën Medicus, ka bashkëvepruar me shumicën nëse jo me të gjithë dhuruesit dhe pranuesit të cilët kanë qenë të përfshirë në të 7 operacionet për transplantimin e veshkave, gjatë përgatitjes së tyre për ndërhyrje kirurgjike, prandaj e ka ditur se të gjithë ata kanë qenë shtetas të huaj. Ky fakt është dashur, të paktën, të ngjallte dyshimin e tij se Klinika ishte përfshirë në"<sup>31</sup> (me theks të shtuar).

72. Vepra penale e krimit të organizuar është përcaktuar në nenin 274 (1) të KPPK-së si në vijim: "Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet". Elementet e veprës penale të krimit të organizuar kërkojnë dëshmi të kryerjes së krimeve të rënda, që është kryer nga një grup i strukturuar për të përfituar, direkt ose indirekt, dobi pasurore a financiare apo përfitime të tjera materiale.

73. Elementet e çdo vepre penale janë unike dhe gjatë vlerësimit nëse ka bashkim efektiv të veprave penale (jo bashkim ligjor), sidomos sikur në rastin në fjalë, kur gjykata ka dhënë një cilësim të ndryshëm juridik të fakteve, është e domosdoshme të kontrollohet nëse faktet e vërtetuara janë të mjaftueshme për të ardhur në përfundim se të gjitha elementet përbërëse të veprës penale të krimit të organizuar janë të pranishme, duke përfshirë *mens rea*. Sa i përket aktakuzës, i pandehuri është akuzuar për krim të organizuar në bazë të nenit 274 KPPK-së<sup>32</sup>,

<sup>31</sup> Shih paragrafin e parafundit në faqe 9 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12. Ky konstatim i Gjykatës së Apelit përputhet me citimin e pjesshëm të aktgjykimit të Gjykatës Themelore (shih paragrafin e dytë në faqe 12 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës – ku vazhdimisht faktet e përshkruara janë konsideruar si mundësim i trafikimit nga pakujdesia).

<sup>32</sup> Neni 274 i KPPK-së përcakton si në vijim: (1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet. (2) Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet. (3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet. (4) Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje. (5) Gjykata mund ta

por vepra penale i është nënshtruar disa ndryshimeve në Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës, në fuqi që nga 1 janari 2013, dhe tani vepra penale është vendosur në nenin 283 të KPRK-së<sup>33</sup>. Dallimet kryesore mes dy versioneve kanë të bëjnë me strukturën dhe teknikën legislative të përdorur në përshkrimin e veprës penale<sup>34</sup>, si dhe me *mens rea* më të kërkuar të

---

lirorë nga dënimi kryerësin i cili kryen vepër penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni nëse personi i tillë, para se grupi të kryejë veprën, e lajmëron policinë apo prokurorin publik në hollësi lidhur me ekzistimin, përbërjen dhe informacionet e grupit të organizuar për t'i mundësuar policisë arrestimin e grupit apo prokurorit publik ndjekjen e atij grupi. (6) Kushdo që është dënuar me dënime plotësuese nga neni 57 i këtij Kodi për kryerjen e veprës penale nga ky nen dhe i shkel kushtet e atyre dënimeve plotësuese, dënohet me burgim deri në një vit. (7) Sipas këtij neni: 1) Shprehja "krim i organizuar" do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare. 2) Shprehja "grup kriminal i organizuar" do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare. 3) Shprehja "krim i rëndë" do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet. 4) Shprehja "grup i strukturuar" do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

<sup>33</sup> Neni 283 i KPRK-së përcakton si në vijim: (1) Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet. (2) Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet. (3) Kur veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar të parapara në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni rezultojnë në vdekje, kryesi dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm. (4) Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë. (5) Për qëllime të këtij neni, "aktivisht merr pjesë" përfshin, por nuk kufizohet në ofrimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të veprimtarive të grupit.

<sup>34</sup> Prandaj, paragrafi i mëparshëm 7, lidhur me përkufizimet, nuk ekziston më, pasi që tani në KPRK, paragrafi i mëparshëm 7.1 (që ishte një lloj përmbledhje e elementeve konstituive të veprave penale) nuk ka korrespondencë në nenin e ri, në paragrafin e mëparshëm 7.2 termi "grup i strukturuar" është zëvendësuar me "bashkim i strukturuar" tani i përkufizuar në nenin 120, paragrafin 14 të KPRK-së, përkufizimi paraprak i "krim i rëndë" i përmbajtur në paragrafin e mëparshëm 7.3 tani është përfshirë në paragrafin e 1-rë të nenit 283 të KPRK-së. Lidhur me paragrafin e mëparshëm 7.4 termi "grup" tani është përkufizuar në mënyrë autonome si "grup njerëzish" në nenin 120, paragrafin 12 të KPRK-së si "tre apo më tepër persona", më tutje nuk është përkufizuar në vepër penale, pasi që se nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atëçastshme të një vepre penale, por që nuk ka nevojë të ketë role të definuara në mënyrë formale për anëtarët e tij, vazhdimësi të anëtarësisë së tij, apo strukturë të zhvilluar. Dallimi tjetër ka të bëjë me bashkimin e "kryerjes" (paragrafi i mëparshëm 1) me "pjesëmarrje aktive" (paragrafi i mëparshëm 2), pasi që më parë këto veprime kriminale janë përshkruar në paragrafë të ndryshëm pa një arsyje logjike për një gjë të tillë, pasi që të dy veprimet janë akoma në kuadër të konceptit të kryerjes. Megjithatë, dënimi cili është paraparë në paragrafin 2 për "pjesëmarrje aktive" (në vend të "kryerjes") ishte më i butë, pasi dënimi minimal i burgimit ishte 5 vjet, pra më i favorshëm, pasi që tani kufizimi i tillë është 7 vjet. Paragrafi i mëparshëm 3 ("Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet") korrespondon me një rrethanë rënduese tani përcaktuar në paragrafin 2, me të njëjtën gjobë, por me një minimum të lartë me burgim, pasi që tani është 10 vjet dhe për këtë arsye nuk është më tutje më i favorshëm. Ish-paragrafi 4 tani korrespondon me paragrafin

përmendur në nenin 283 (1) të KPRK-së, pasi që tani ligjvënësi ka sqaruar se kryesi duhet të veprojë "me dashje dhe me njohuri qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim" (me theks të shtuar).

74. Megjithatë, në të dyja versionet, nuk ka vend për dyshim për nevojën e dashjes direkte, pasi që ajo eventuale nuk mjafton (kjo nuk është në përputhje me strukturën dhe natyrën e veprës penale), për ta kryer këtë vepër penale. Siç është përcaktuar në nenet 14 (2) dhe (3) të KPPK-së dhe 21 (2) dhe (3) KPRK-së, "personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj" dhe "personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj", respektivisht. Në veprën penale të krimit të organizuar, kryerësi mund të jetë çdo person, pra duke qenë një vepër penale e zakonshme - pasi që nuk ka kërkesa të veçanta që duhet të plotësohen nga agjenti<sup>35</sup>. Në lidhje me vlerën juridike e mbrojtur nga kjo vepër penale, është dominuese ideja në doktrinë se "paqja është publike", "siguria e brendshme" dhe rendi - sundimi i ligjit, shtetësia<sup>36</sup> ka për qëllim shmangien e rrezikut social. Kolegji pajtohet me qasjen doktrimore se është e mundur që vetëm të flitet për krimin e organizuar, kur bashkimi i vullneteve të anëtarëve gjeneron një entitet autonom, të ndryshëm dhe mbi atë vetë anëtarëve.
75. Për të analizuar elementet e veprës penale të krimit të organizuar, kolegji së pari kthehet në çështjen e kryerjes së veprës penale bazë si kusht i veprës penale të krimit të organizuar. Gjykata Supreme në vendimet e saj të mëparshme ka theksuar se vepra penale e krimit të

---

3, versioni i ri në mënyrë të saktë i referohet 2 formave të kryerjes të cilat janë përmendur më parë në paragrafët 1 dhe 2, pasi më parë rrethana rënduese të përmendura vetëm në paragrafin 2, jo në atë 1, nuk ishte e kuptueshme. Përveç kësaj, minimumi i burgimit të parashikuar tani është më i lartë, pasi që është 10 vjet burgim. Paragrafi aktual 4 korrespondon me paragrafin e mëparshëm 3 dhe nuk është më i favorshëm, pasi që tani gjykata mund ta zvogëlojë vetëm dënimin ndërsa më parë ka mundur ta tërheqë. Përfundimisht, nuk ka ekuivalent me paragrafin e mëparshëm 6 dhe tani paragrafi 5 është përkufizimi i shprehjes "pjesëmarrjes në mënyrë aktive".

<sup>35</sup> "Se vepra penale nën paragrafin 1 të këtij neni mund të kryhet nga çdo person" - shih pikën 6 nën paragrafin 1 të Komentarit për nenin 283 ("Kodi Penal i Republikës së Kosovës", Komentar, Botimi I", nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Bonn dhe Eschborn, Gjermani).

<sup>36</sup> Në pajtohemi me Santos Cabette (Profesorin e së drejtës penale në fakultetin juridik të Universitetit të Sao Paulo, USP, Brazil) se kjo vepër penale mbron një rrezik abstrakt (shih <http://jus.com.br/artigos/31419/bem-juridico-tutelado-nos-crimes-de-organizacao-ou-associacao-criminosa>).

organizuar kërkon kryerjen e veprës penale bazë, përveç vetë veprës penale të krimit të organizuar.<sup>37</sup>

76. Në rastin konkret, kolegji ka analizuar veprën penale bazë të trafikimit me njerëz më parë në aktgjykim. Lidhur me të pandehurin S [REDACTED] H [REDACTED], akuza e veprës penale të trafikimit me njerëz në shkelje të nenit 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 23 KPPK-së është ri-cilësuar (përsëri) në mundësimin e veprës penale të trafikimit me njerëz nga pakujdesia në kundërshtim me nenin 139 (4) të KPPK-së, dhe më pas e ka refuzuar, për shkak të nenit 2 (2) dhe (3) të KPPK-së ose nenit 3 (2) dhe (3) të KPRK-së dhe formulimit të ri të veprës penale, sipas nenit 171 të KPRK-së, ku pakujdesia më nuk është parashikuar (me pasojat e përcaktuara në nenet 11 (3) të KPPK-së ose 17 (2) të KPRK-së). Prandaj, kolegji konstaton se kjo vepër penale (krim i organizuar) nuk është kryer nga i pandehuri pasi që, në radhë të parë, elementi thelbësor i kryerjes së veprës penale bazë mungon; siç është shpjeguar tashmë, secili bashkëkryerës është përgjegjës vetëm në kufijtë e fajit të vet, "brenda kufijve të dashjes së tij ose të saj vetë ose pakujdesisë". Për më tepër, edhe nëse mund të konsiderohet se mos zbatimimi i një dënimi për një vepër penale është i ndryshëm nga të kryerit apo jo (si një kusht për një tjetër) akoma elementet e mbetura përbërëse të veprës penale nuk janë vërtetuar, e shumë më pak janë arsyetuar, nga cilado gjykatë në lidhje me atë. Në këtë drejtim, mungesa e fakteve që çon në dashjen e nevojshme (direkte) specifike tashmë është theksuar, gjatë adresimit të mungesës<sup>38</sup> së fakteve që lidhen me dashjen në veprën penale të trafikimit me njerëz, këtu e zbatueshme *mutatis mutandis*. Rrjedhimisht, S [REDACTED] H [REDACTED] është liruar nga vepra penale e krimit të organizuar në shkelje të nenit 274 (1) të KPPK-së.

#### - Vepra penale lëndim i rëndë trupor

77. Kolegji tani kthehet tek vepra penale e lëndimit të rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së. Lëndimet trupore në formën e saj themelore janë paraparë në nenin 153 KPPK-së. Kjo vepër penale konsiderohet si vepër penale kundër jetës dhe trupit të një personi dhe

<sup>37</sup> *Shih* Gjykata Supreme, aktgjykimi nr. Ap-KZ 61/2012 i datës 2 tetor 2012, paragrafi 48; aktgjykimi i Gjykatës Supreme Nr. PAKR 2015/2014, i datës 14 maj 2015.

<sup>38</sup> *Shih* jo faktet e reja të vërtetuara por konstatimet në lidhje me S [REDACTED] H [REDACTED] në faqe 52, paragrafët 2 dhe 3, dhe faqet 57 deri 59 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe integritetit trupor si një nga vlerat themelore në një shoqëri demokratike. Termi "Shëndeti" është përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si "një gjendje e plotë fizike, mendore dhe e mirëqenies sociale dhe jo thjesht vetëm mungesë e sëmundjes ose dobësisë". Në kuptim të *mens rea* ("elementi subjektiv" në doktrinën kontinentale), mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. Elementet normative objektive ("lëndim trupor" dhe në rastin e formës së rëndë, gjithashtu "dëmton shëndetin") kërkon që lëndimi të jetë "shumë i rëndë", por jo domosdoshmërisht i përhershëm, me kohëzgjatje të madhe ose kërcënues për jetën.

78. Lëndimi i rëndë trupor është e paraparë në nenin 154 të KPPK-së, kjo është formë e rëndë e kryerjes (dhe në aspektin *mens rea* përfshin pakujdesinë në rastet e përmendura në paragrafin 5), për shkak të një nivel më të lartë të fajit apo intensitetit në shkelje të vlerave juridike penalisht të mbrojtura. Neni përcakton qartë mënyrat se si lëndimi i rëndë trupor mund t'i shkaktohet një personi (elemente përshkruese objektive): ose duhet të rrezikojë jetën e personit, të shkatërrojë ose të dobësojë një organ ose dobësojë një organ vital të një personi tjetër, pengoj kapacitetin e një personi për të punuar ose dëmtojë shëndetin e një personi tjetër. Të gjitha këto akte dëmtojnë rëndë shëndetin e një personi. Nëse një lëndim përbën lëndim të rëndë trupor duhet të përcaktohet nga gjykata nga rasti në rast. I pandehuri ishte në dijeni<sup>39</sup> për veprimet të tij, se ishin të kundërligjshme dhe të dënueshme me ligj dhe me vetë dëshirë i ka kryer ato<sup>40</sup>.

79. Kolegji konstaton se Gjykata Themelore ka ri-cilësuar saktë veprën penale si shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së – duke e dobësuar në mënyrë të përhershme dhe të ndjeshme organi e një personi tjetër – në bazë të provave të paraqitura në lëndë dhe deklaratën e mjekut ligjor C [REDACTED] B [REDACTED]. Prandaj, kolegji plotësisht pajtohet me analizën e funksionit të veshkave në trupin e njeriut, si dhe të pasojave të heqjes së një veshkë nga trupi i një personi të shëndetshëm të bërë nga Gjykata Themelore në faqet 122 dhe 123 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Kolegji konsideron se elementet objektive

<sup>39</sup> "Kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse ai apo ajo është mentalisht i aftë dhe qëllimisht apo nga pakujdesia ka kryer vepër penale" [neni 17(1) i KPRK-së], pasi që aftësia mendore gjithashtu është kusht i përgjegjësisë penale dhe patjetër duhet të përmendet në mënyrë eksplicite në aktgjykim.

<sup>40</sup> Pasi që "njohuria, dashja, pakujdesia ose qëllimi si element i veprës penale mund të nxirren nga rrethanat faktike" dhe gjithmonë patjetër duhet të përmenden në mënyrë eksplicite në aktgjykim (neni 22 i KPRK-së).

të lëndimit të rëndë trupore, në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së, janë vërtetuar plotësisht. Kolegji, do t'i përmbahet parimit se dispozita në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale është e zbatueshme [neni 2 (1) i KPPK-së ose 3 (1) i KPRK-së] duke pasur parasysh se nuk ka vend për ndonjë përjashtim, nuk ka ligj më të favorshëm për të aplikuar [neni 2 (2) i KPPK-së ose 3 (2) i KPRK-së], pasi që neni 189 (1.2) dhe (1.3) i KPRK-së nuk ndryshon elementet përbërëse të veprës penale apo sanksionet e zbatueshme.

80. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë gjetur se transplantimet e veshkave të kryera në Klinikën Medicus ishin në shkelje të nenit 46 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, Ligjit Nr.2004/4. Më tutje, transplantimet e veshkave janë kryer pa asnjë leje apo autorizim<sup>41</sup>. Prandaj, kolegji konsideron se faktet dhe provat në lidhje me kundërligjshmërinë e transplantimit të veshkave janë provuar plotësisht nga Gjykata Themelore dhe janë vërtetuar drejtë nga Gjykata e Apelit. Kolegji, dhe në lidhje me këtë çështje, gjithashtu e bën një referencë tek detyrat profesionale të të pandehurit dhe thekson se para të qenit anesteziolog ai është një mjek dhe për këtë arsye është i detyruar nga *lege artis*. Ai nuk mund të thotë thjeshtë se nuk e ka drejtuar apo nuk ka pasur ndonjë funksion administrativ në Klinikë.

81. Kolegji pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se kundërligjshmëria e procedurës mjekësore është ajo që krijon veprën penale të lëndimit të rëndë trupor. Avokati mbrojtës pretendon se S ■■■ H ■■■ nuk e ka pasur obligim që t'i përmbahet dispozitave të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës. Përkitazi me këtë, kolegji thekson se parimi i *ignorantia juris non excusat* do të thotë se personi i cili nuk është në dijeni të ligjit nuk mund t'i ikë përgjegjësisë për shkeljen a tij ligji thjesht sepse ai ose ajo nuk ishte në dijeni të përmbajtjes së tij, por, përsëri, për atë si mjek vlen *lege artis*. Prandaj, mungesa e supozuar e njohurisë së dispozitave të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës nuk mund të përdoret si mbrojtje në rastin në fjalë. I pandehuri është angazhuar në mënyrë aktive në transplantimin e veshkave, ka komunikuar me pacientët para ndërhyrjeve kirurgjike, dhe ka mbajtur shënime për të gjitha ndërhyrjet në të cilat ka marrë pjesë. Kolegji pajtohet me Gjykatën Themelore se ekzistojnë prova që vërtetojnë se S ■■■ H ■■■ ka vepruar me dashje direkte dhe, siç është cekur


<sup>41</sup> Shih faqet 45 deri 52 të aktgjykimit P 309/10 dhe P 340/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe faqet 53 to 54 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

tashmë, ky aktgjykim e hedh poshtë argumentin e avokatit mbrojtës se i pandehuri nuk ka qenë i obliguar t'i përmbahet dispozitave të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

82. Kolegji vëren argumentin e të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës se S [REDACTED] H [REDACTED] ka vepruar vetëm si anesteziolog dhe nuk ka hequr ndonjë veshkë. Kolegji pajtohet me këtë deklaratë pasi që ajo rrjedh nga gjendja faktike në tërësi. Megjithatë, kolegji thekson se forma e kryerjes së kësaj vepre penale është bashkëkryerje me të bashkëpandehurit e tjerë dhe siç është cekur më parë jo të gjithë bashkëkryerësit duhet të kryejnë të njëjtat veprime dhe secili është përgjegjës vetëm brenda kufijve të dashjes apo pakujdesisë së tij ose të saj.
83. Siç është cekur më parë *en pasasant*, kolegji pajtohet me argumentin e paraqitur nga Prokuroria gjatë fazës së apelit në Gjykatën e Apelit<sup>42</sup> se ka bashkim të veprave penale mes lëndimit trupor (i rëndë, në rastin në fjalë) dhe trafikimit me njerëz. Kolegji nuk pajtohet me pohimin se " është dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale"<sup>43</sup>. Kjo ka të bëjë me dënimin për dy vepra të ndryshme penale, pasi që me të njëjtën vepër janë shkelur dy vlera të ndryshme juridike (nga pikëpamja natyrore, që është bashkim ideal): në qoftë se është e vërtetë se askush nuk mund të dënohet dy herë për të **njëjtën** vepër penale (*ne bis in idem*), kjo nuk mund të gabohet për bashkimin ideal të veprave penale, madje as kur është një bashkim homogjen (vepra të ndryshme penale duke shkelur vlerat të ndryshme juridike), aq më pak kur është heterogjene konkurrencën (veprat dallueshme penale shkelur vlera të ndryshme juridike). Në fakt, vlerat juridike të mbrojtura nga këto vepra penale janë të ndryshme. Trafikimi me njerëz mbron dinjitetin njerëzor nga shfrytëzimi, dhe lëndimi i (rëndë) trupor, mbron shëndetin, integritetin e një individi në tërësi.
84. Kolegji tashmë ka theksuar se referimi në veprën penale të trafikimit me "heqjen e organeve" [neni 139 (8.2) i KPPK-së dhe 171 i (6.2) KPRK-së] është bërë si një shembull i thjeshtë i asaj që çfarë elementi përbërës mund të jetë "shfrytëzimi". Shprehja "por jo vetëm" është përdorur madje edhe nga ligjvënësi. Në kontrast me të kuptuarit e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, një vepër penale nuk është element i një vepre tjetër penale. Kjo mund të ndodhë në rast të veprës së njëjtë penale, por në mënyra të ndryshme të

<sup>42</sup> Shih faqe 37 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>43</sup> Shih paragrafin e dytë të faqes 61 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.





kryerjes, për shembull, forma e thjeshtë dhe e rëndë (bashkim ligjor i krimeve), si në rastin e vrasjes dhe vrasjes së rëndë, lëndimit trupor dhe lëndimit të rëndë trupor, etj. Në këto situata, nëse individi është dënuar për formën e rëndë, ai ose ajo nuk mund të dënohet edhe për formën bazë. Ajo që kemi në veprën penale të trafikimit është shembuj të elementeve "shfrytëzimit" (edhe pse jo të kufizuara në ato të përmendurat", por jo vetëm"). Referenca në "heqjen e organeve", është vetëm si shembull. Elementi "heqja e organeve" nuk është "element apo veprë penale" pjesë e veprës penale të trafikimit me njerëz. Si një shembull i qartë i bashkimit në mes të këtyre dy vepra penale, ka lloje të ndryshme të kësaj veprë penale: trafikimi për prostitucion (si në vendet ku prostitucioni është i ligjshëm ashtu edhe në vendet ku është i kundërligjshëm), trafikimi për punë në skllavëri (e papaguar, pa orar pune, ushqim, kushte sanitare apo të jetesës, etj) dhe për shumë qëllime të tjera. Njëri prej tyre nënkupton shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor - heqjen e organeve me qëllim të transplantimit. Është e qartë se një individ mund të jetë viktimë e trafikimit, pa pësuar lëndim të rëndë trupor.

85. Përsëri, për të përfunduar referencën për bashkimin e veprave penale<sup>44</sup>, kolegji është ose do të jetë i detyruar nga *reformatio in pejus*, sepse identiteti i të pandehurve nuk është prekur (pasi që në këtë ankesë kemi adresuar vetëm të pandehurin S [REDACTED] H [REDACTED]).

86. Prandaj, kolegji përfundon se Gjykata Themelore ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike (përfshirjet e bëra në çështjet e mëparshme tashmë të adresuara gjatë këtij gjykimi) dhe të provave, dhe plotësisht ka vërtetuar elementet e veprës penale të lëndimit të rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së. Rrjedhimisht, S [REDACTED] H [REDACTED] është gjetur fajtor për lëndime të rënda trupore në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së.

#### - Dënimi

<sup>44</sup> Pasi që nuk është subjekt i kësaj anese, ky aktgjykim nuk do ta adresojë problemin identik por në lidhje me mungesën e bashkimit në mes të veprave penale të krimit të organizuar dhe veprës penale, bazë – në kuptimin e përshkruar dhe të mbrojtur nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit në faqet 60 dhe 61 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

87. Në bazë të nenit 64 (1) të KPPK-së, Gjykata e cakton dënimin për veprë penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë veprë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Përveç kësaj, dënimi duhet të jetë në proporcional.
88. Në rastin konkret, Gjykata Themelore ka konsideruar si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri nuk ishte i dënuar më parë, dhe si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri ka mbajtur një pozicion të rëndësishëm si anesteziolog kryesor i cili ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shumicën e ndërhyrjeve kirurgjike, dhe me qëllim që të mbledh të holla. Më tej, ai ka marrë qasje oportuniste për të mos pyetur lidhur me rrethanat e ndërhyrjeve kirurgjike. Pas vlerësimit të këtyre rrethanave, Gjykata Themelore ka konsideruar se 3 (tre) vjet burgim për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për ta përmbushur qëllimin e dënimit. Përveç kësaj, duke pasur parasysh se vepra penale përbën rrezik të madh për sigurinë publike, Gjykata Themelore në bazë të nenit 57 (1) dhe (2) të KPPK-së ka shqiptuar dënimin plotësues të ndalimit për të ushtruar profesionin e anesteziologut për periudhën prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.
89. Gjykata e Apelit e ka ndryshuar dënimin e shqiptuar nga Gjykata Themelore dhe ka treguar se si i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale trafikim me njerëz (për krim të organizuar në lidhje me trafikim me njerëz), në shkelje të nenit 139 të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së, dënimi prej 5 (pesë) viteve burgim dhe gjoba prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro është e përshtatshme për të pasqyruar nivelin e përgjegjësisë penale. Gjykata e Apelit ka marrë në konsideratë të njëjta rrethana lehtësuese dhe rënduese sikurse Gjykata Themelore. Megjithatë, Gjykata e Apelit e ka ndryshuar dënimin plotësues të shqiptuar nga Gjykata Themelore. Gjykata e Apelit arriti në përfundim se dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit do të fillojë pasi i pandehuri ta ketë vuajtur

burgimin për t'u siguruar që dënimi plotësues nuk do të fillojë në të njëjtën sikur dënimi me burgim.

90. Kolegji ka marr parasysh se në këtë aktgjykim vepra penale e trafikimit me njerëz është rilësuar (përsëri) në veprën penale mundësim i veprës penale të trafikimit nga pakujdesia në shkelje të nenit 139 (4) të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së, dhe është refuzuar për shkak të nenit 2 (2) dhe nenit 11 (3) të KPPK-së apo neneve 3 (3) dhe 17 (2) të KPRK-së dhe formulimit të ri të veprës penale sipas neni 171 KPRK-së; S ■■■ H ■■■ është duke u liruar nga akuza penale për krim të organizuar (në lidhje me trafikimin me njerëz), në kundërshtim të nenit 274 (1) të KPPK-së; dhe se S ■■■ H ■■■ është shpallur fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor, që rezultuar në "shkatërrimin ose dobësimin në mënyrë të përhershme dhe të ndjeshme të një organi ose një pjese të trupit të personit", në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së. Prandaj, kolegji konsideron se dënimi me 5 (pesë) vite burgim dhe me gjobë prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro të shqiptuar nga Gjykata e Apelit nuk do të jetë i zbatueshëm këtë lëndë.

91. Ky kolegji pajtohet me pohimet e bëra nga Gjykata e Apelit për mënyrën dhe kriteret se si të përcaktohet dënimi<sup>45</sup> dhe se do t'i përmbahen atyre në vlerësimin e tij. Kolegji, gjithashtu merr parasysh rrethanën që së paku<sup>46</sup> 7 (shtatë) transplantime dhe jo 24 (njëzet e katër) janë vërtetuar nuk do të ndikojë në dënimin përfundimtar. Edhe pse numri i transplantimeve të provuara tani është më i vogël (që në fakt lidhet me intensitetin e rrezikut për vlerën e mbrojtur juridike), kolegji është i mendimit se kohëzgjatja e veprës penale është e natyrës esenciale. I pandehuri ka vepruar gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore (nuk bëhet fjalë për një javë, por për 5 muaj e gjysmë - ai ka vepruar nga 15 maji 2008 deri më 31 tetor 2008, që ka qenë një periudhë e konsiderueshme kohore për ta ndryshuar mendjen). Prandaj, gjatë vlerësimit të kriterit "rrethanat në të cilat është kryer akti", gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar periudhën e gjatë kohore përgjatë së cilës ka ndodhur akti si dhe nivelin intensiv të shkeljes së *lege artis*. Për më tepër, është e rëndësishme të vërehen rrethanat tjera

<sup>45</sup> *Shih* paragrafët e mesit në faqe 63 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 52/12.

<sup>46</sup> "Të paktën" siç është konstatuar në të gjitha shkallët se kanë ndodhur 7 transplantime, asnjëherë nuk është vërtetuar se nuk kanë ndodhur të tjera, dhe nga pikëpamja juridike nuk bie në kundërshtim me parimin e prezumimit të palajësisë, është një gjë të thuhet "të paktën 7" dhe është ndryshe të thuhet "më shumë se 7"; përveç detajeve në formulim, nuk ka pasojë juridike për përgjegjësinë penale ose dënimin.


rënduese posaçërisht se në cilësinë e anesteziologut kryesor ai ka pasur një rol kyç në ndërhyrjet kirurgjike që ishin kryer (pa e përfshirë dhe tejkaluar konceptin e "bashkëkryerjes"). Kështu, kolegji është i mendimit se gjykata e shkallës së parë ka qenë e butë në vlerësimin e ekuilibrit në mes të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, përkatësisht për shkak se, kolegji më tutje pajtohet me Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit se vepra penale e kryer nga i pandehuri paraqet rrezik për sigurisë publike. Për të gjitha këto arsye (dhe për shkak të parimit të ndalimit *reformatio in pejus* – i cili e kufizon gjykatën për burgim deri në 3 vjet), kolegji konsideron se dënimi me 3 vite burgim është i përshtatshëm. Prandaj, kolegji i shqipton të pandehurit S ■■■ H ■■■ dënimin me 3 (tre) vite burgim për veprën penale lëndimi i rëndë trupor në shkelje të nenit 154 (1.2) të KPPK-së.

92. Përfundimisht, kolegji konsideron se Gjykata e Apelit ka përcaktuar drejtë se në rast se dënimi plotësues ["ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës", i paraparë në nenet 54 (2.4) dhe 57 të KPPK-së] fillon së bashku me dënimin e shqiptuar me burgim, ai do ta humbasë qëllimin e tij. Prandaj, aktgjykimi i Gjykatës Themelore është ndryshuar në mënyrë që ndalimi i ushtrimit të profesionit të fillojë pasi i pandehurit ta ketë vuajtur burgimin për t'u siguruar që dënimi plotësues nuk do të fillojë në të njëjtën kohë me dënimin me burgim. Përveç kësaj, neni 63 (2) i KPPK përcakton se "*ekzekutimi i dënimit plotësues nga pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 e nenit 54 (2) të këtij Kodi fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim*". Në fund, pasi që nenet 66 (2) dhe 72 (2) të KPRK-së nuk janë më të favorshme në asnjë mënyrë, kolegji do t'i përmbahet parimit se ligji në fuqi në atë kohë është i zbatueshëm, përveç nëse një ligj i ri më i favorshëm hyn në fuqi [neni 2 (2) dhe (3) i KPPK-së apo nenet 3 (1) dhe (2) të KPRK-së], dhe se ligji që rregullon dënimin kryesor është ai që rregullon dënimin plotësues.

**Në bazë të asaj që u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv.**

**Kryetar i kolegjit**

**Procesmbajtëse**



**Jorge Martins Ribeiro**  
Gjyqtar i EULEX-it

**Sandra Gudaityte**  
Zyrtare ligjore e EULEX-it

**Anëtarët e kolegjit**

\_\_\_\_\_  
**Anders Cedhagen**  
Gjyqtar i EULEX-it

